

REPORTI MONITORUES DHE VLERESUES, JANAR 2011-PRILL 2012

TRANSPARENCA DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT NE VENDIMARRJEN E KEŞHILLIT BASHKIAK KORÇË

RAPORT MONITORUES DHE VLERËSUES

**TRANSPARENCA
DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT
NË VENDIMARRJEN E
KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË**

PERIUDHA E MONITORIMIT:

JANAR 2011-PRILL 2012

(16 MUAJ)

Një botim i Qendrës për Çështje të Informimit Publik, ÇIP



Website: www.infocip.org
e mail: qendra@cip-al.org

© copyright 2012 - Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP

Grupi i punes, ÇIP, Tirane

Gerti Shella, ekspert për aksesin në legjislacion & drejtor projekti
Eniel Kolaneci, trainer i ZTQ
Anila Aliraj, kordinator
Arlinda Selmani, koordinator

ZTQ, Korçë:

Av. Aleksander Dino
Rirvan Meçolari
Erget Cenolli
Lumturie Zerellari
Engjellushe Korturi
Pjerin Simo

Website & Database administrator

Ermir Tufa
Dritjon Selmani

Autor i metodës dhe redaktor i studimit

Gerti Shella

Perkthimi Shqip-Anglisht:

Ergys Bezhani
Enkela Xhamaj

* * *

Në kuadër të projektit:

Forcim i transparencës në qeverisjen vendore përmes nxitjes së pjesëmarrjes qytetare dhe monitorimit të procesit vendimarrës.

Mbështetur nga:
Fondacioni për Shoqërinë e Hapur (SOROS)



Mendimet dhe konsideratat e shprehura në këtë publikim janë të autorëve
dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Përbajtja

HYRJE 7

PJESA E PARË

KUADRI LIGJOR DHE LEGJITIMITI I MONITORIMIT 11

PJESA E DYTË

GJETJET E MONITORIMIT	19
ZBATUESHMËRIA E NENIT 33	22
VOTIMI I FSHEHTE I VENDIMEVE ME KARAKTER INDIVIDUAL (Neni 33/1)	22
VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME SHUMICË TË THJESHTË (neni 33/2 & 33/3)	23
VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME TRE TË PESTAT (neni 33/4)	24
SHPALLJA DHE HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (neni 33/6)	24
ZBATUESHMËRIA E NENIT 34	27
MBLEDHJET E HAPURA (Neni 34/1)	27
NJOFTIMI I MBLEDHJEVE të Këshillit Bashkiak (neni 34/2)	28
MBLEDHJET E MBYLLURA (neni 34/3)	29
ZBATUESHMËRIA E NENIT 35.....	30
KËSHILLIMI ME BASHKËSINË (neni 35/1 dhe 35/2).....	30
AFISHIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (neni 35/3).....	32
ANEKS Nr. 1	35

PJESA E TRETË

MATJA E ZBATUESHMËRISË SË NENEVE 33, 34, 35 DHE E TRANSPARENCEΣ

PJESA E KATËRT

REKOMANDIME	55
METODOLOGJIA	59
ANKES Nr. 2	61
REFERENCAT	67

FALENDERIME

*Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP,
falenderon Fondacionin për Shoqërinë e Hapur,
SOROS
për besimin dhe mbështetjen që i siguroi e kësaj nisme.*

*Një falenderim special shkon edhe për
Sekretarët e Këshillit Bashkiak, Korçë,
të cilët lehtësuan punën stafit të Qendrës ÇIP dhe të
Zyrës për Transparencë Qytetare Korçë gjatë procesit të
dixhitalizimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak të
marra që nga viti 2007.*

*Falenderimet e fundit janë për stafin e Qendrës ÇIP
si dhe për drejtuesit dhe anëtarët e
Zyrës për Transparencë Qytetare në Korçë
të cilët demostruan përkushtim
gjatë procesit të vëzhgimit nga afér në sallë të
mbledhjeve të Këshillit Bashkiak
dhe sollën inpute të dobishme për eksperitet e ÇIP në
Tiranë që hartuan këtë Raport.*

HYRJE

Raporti **"Transparenca dhe Pjesëmarrja e Publikut në Vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Korçë"** është produkti final i një nisme të re të ndërmarrë nga Qendra për Çështje të Informimit Publik. Objekt monitorimi dhe vlerësimi në kuadër të kësaj nisme është aktiviteti dhe funksionimi i Këshilli Bashkiak në dy aspekte të përcaktura qartësisht në ligj¹: garantimi i pjesëmarjes së publikut në vendimarje dhe realizimit të një procesi vendimarrës konform kërkesave të përcaktuar qartësisht në ligj përsa i takon ***diskutimit paraprak, votimit*** dhe ***shpalljes e vendimeve***. Monitorimi në Korçë u realizua falë mbështetjes së rëndësishme të ofruar nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur, SOROS.

Periudha të cilën mbulon ky monitorim fillon në Janar 2011 dhe përfundon në Prill 2012. Arsyja që kjo periudhë e tejkalon me katër muaj vitin kalendarik ka të bëjë me miratimin në intervalin kohor Shkurt-Prill 2012 të Paketës Fiskale dhe Buxhetit nga Këshilli Bashkiak, Korçë. Këto janë praktikisht dy vendimarrjet më të rëndësishme vjetore të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësojnë një interes parësor monitorimi dhe vlerësimi. Edhe në vitin 2011, Paketa Fiskale u diskutua dhe u kalua përafërsisht në këtë periudhë, ndërkohë që vendimi për Buxhetin, pavarësisht se nisi të shqyrtohet në të njëjtën kohë me Paketën Fiskale, u kalua vetëm në muajin Korrik, pas konstituimit të këshillit të ri bashkiak pas Zgjedhjeve Vendore të Majit,

2011. Në një kuptim të dytë, mund të thuhet se monitorimi mbulon plotësisht një periudhë kohore, që nis dhe mbaron me miratimin e paketave fiskale dhe buxheteve respektive për 2011-ën dhe 2012-ën.

Risia e këtij monitorimi është se për herë ai ndërthur një ***vlerësim të dyfishtë*** të së drejtës² së publikut për pjesëmarrje në vendimarrjen lokale dhe të detyrimit të Këshillit Bashkiak për të realizuar vendimarrjen të hapur dhe me pjesëmarrje konform dispozitave relevante³ të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar⁴.

Për të realizuar këtë vlerësim të dyfishtë, Qendra CIP dizenjoi një mjet metodologjik të posaçëm, të emërtuar ***PROAKTIV***, që përfaqëson një ndër prurjet më të rëndësishme të kësaj nisme. ***PROAKTIV*** (*akronim i modifikuar për: Protokoll i Vlerësimit të Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*) është *sui-generis*, që do të thotë se është konceptuar apo "*qepur pas trupit*" të legjisacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ***ligji 8652*** "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Është e qartë se në fokus të këtij monitorimi special, i cili realizohet për herë të parë në mënyrë kaq të detajuar, është ekskluzivisht veprimtaria e Këshillit Bashkiak, i cili ushtron funksionet e organit kolegjal vendimarrës në nivel vendor. Administrata e Bashkisë, si një organ i centralizuar monokratik,

që drejtohet nga kryetari i bashkisë, nuk është objekt monitorimi. Kjo përqasje diferençuese përfaqëson një tjetër risi, nëse mbahet parasysh se deri më sot nuk i është kushtuar kujdes ndarjes dhe veçimit të funksioneve vendimarrëse dhe atyre ekzekutive në nivel vendor nga operatorët e shoqërisë civile, në kontekstin e matjes dhe vlerësimit prej tyre të transparencës qeverisëse.

ÇIP ka përllogaritur edhe nivelin e zbatueshmërisë së dispozitave relevante të ligjit organik 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar nga vetë Këshilli Bashkiak, Korçë. Konkretnisht, objekt matjeje dhe vlerësimi në kuadër të këtij Raporti është zbatushmëria (*implementimi*) e neve 33, 34 dhe 35 të ligjit në fjalë. Këto ne-ne përcaktojnë modalitetet e *diskutimit paraprak* (me publikun), *votimit, shpalljes* dhe *hyrjes në fuqi* të vendimeve të Këshillit Bashkiak. Zbatimi i dispozitave që ato përbajnë është kusht juridik dhe faktik për të garantuar vendimarrje transparente, pjesëmarrje të publikut në procesin vendimarrës si dhe akses të publikut në legjislacionin vendor (*njojje efektive me aktet e Këshillit Bashkiak*).

Është e qartë se, në kuadër të këtij studimi, **aksesi i publikut në vendimet e Këshilli** nuk është e njëjtë gje me **aksesin e publikut ne vendimmarrje**. Ky dallim i qartë i këtyre dy koncepteve, edhe pse ato janë në fakt organikisht të lidhura, ofron avantazhe të qarta metodologjike në vlerësimin e transparencës së të gjitha hallkave të procesit vendimarrës. Kjo ndarje konceptesh dhe vlerësimesh mund të konsiderohet një tjetër

risi e rëndësishme e kësaj nisme.

Rezultatet e përllogaritjes së nivelit të zbatueshmërisë së këtyre dispozitave ofrohen numerikisht dhe në përqindje. Kjo matje realizohet gjithashtu për herë të parë në Shqipëri. Metoda e zhvilluar dhe e përdorur nga ÇIP, mund të shërbejë si model edhe për aktorë të tjera të interesuar në përllogaritjen objektive të nivelit të zbatimit të ligjeve apo dispozitave të veçanta që janë objekt i punës së tyre në nivel të qeverisjes vendore.

Gjetjet e këtij monitorimi kanë target specifik Këshillin Bashkiak, Korçë, por pa përjashtuar edhe administratën (ekzekutivin) e bashkisë. Një target tjetër specifik janë donatorët (qeveritarë ose jo-qeveritarë) të cilët punojnë me qeverisjen vendore dhe komunitetin. Një tjetër target i synuar janë mediat, lokale dhe kombëtare, të cilat tregojnë një interesim të vazhdueshëm lidhur me proceset vendimarrëse në qytetin e Korçës. Po ashtu, ky Raport i vihet në dispozicion edhe të gjithë qytetarëve korçarë, të cilët, për më tepër, kanë dhënë një kontribut direkt në procesin e monitorimit përmes Zyrës për Transparency Qytetare që u ngrit atje nga ÇIP.

Ky Raport bëhet publik në një kohë kur Këshilli Bashkiak Korçë do të duhet të nisë konsultimet me publikun dhe aktorët e interesuar në kuadër të vendimarrjeve të rëndësishme siç janë Paketa Fiskale dhe Buxheti 2013. Vlerësimi objektiv i performancës përvitin 2012 ofron një mundësi për reflektim me symin përmirësimin e praktikës së përfshirjes reale dhe efektive të publikut në këto vendimarrje shumë të rëndësisme të push-

tetit vendor. Po ashtu, në vitin 2013 pritet edhe hartimi dhe më pas miratimi nga Këshilli Bashkiak i Planit të Përgjithshëm Vendor të Korçës, proces i cili i njeh përgjegjësi të reja dhe mjaft të rëndësishme Këshillit Bashkiak.

Raporti **"Transparenca dhe Pjesëmarrja e Publikut në Vendimarrjen e Këshillit Bashkiak, Korçë"** publikohet kur mbeten dhe më pak më shumë se një vit nga koha e caktuar për implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale në Administratën Publike, 2009-2013 (SNRAP). Pjesë e vizionit qeverisës, të shprehur në këtë dokument të rëndësishëm është "*një administratë që bazohet në procese vendimarrëse transparente, përfshirese dhe të përgjegjshme ndaj publikut*". Gjetjet e këtij raporti ofrojnë një mundësi më shumë për vlerësimin e realizimit të objektivave të shprehura në kuadër të SNRAP, sidomos sa i takon "*preceseve vendimarrëse transparente*".

Ky Raport bëhet publik gjithashtu në një kohë ku Shqipëria i është bashkuar edhe nismave globale që synojnë rritjen e transparencës në qeverisje, siç është **Partneriteti për Qeverisjen e Hapur** (bashkuar më 2/8/ 2011).

Qendra ÇIP, si një operator i shoqërisë civile i specializuar në fushën e aksesit në legjislacion dhe transparencës së botimeve zyrtare, i përmbahet motos se "*Qytetarët shqiptarë duhet ta dinë se çfarë vendimesh merren në emër të tyre*". Aktet zyrtare, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, janë një aset publik, dhe si të tilla ato duhet të jetë në përdorim dhe të aksesueshme efektivisht prej të gjithëve. Në kuadër të reformave që synojnë decentralizimin, aksesi në legjislati-

cionin vendor merr një rëndësi të veçantë në kontekstin aktual. Organet e qeverisjes vendore, konkretisht Këshillat Bashkiakë / Komunalë, ushtrojnë sot një veprimtari vendimarrëse me fushë të gjerë veprimi. Me kompetencat e larmishme që atyre iu janë njohur me ligj, organet e qeverisjes vendore marrin vendime të rëndësishme për territorin dhe pronën, taksat dhe tarifat vendore, për marrje kredie dhe grantesh, etj. Vendime kaq të rëndësishme, me një impak të drejtpërdrejtë mbi popullatën dhe territorin, duhet detyrimisht të mbahen nën vëzhgimin e vazdueshëm të publikut dhe aktorëve të specializuar të shoqërisë civile. Kjo mbikqyrje mund të realizohet si përpara procesit vendimarrës (*përmes pjesëmarrjes së aktorëve të interesuar dhe publikut*), si gjatë procesit të votimit të projekt akteve (*mënyra e votimit, kuorumi, etj*) ashtu edhe pas marrjes së vendimit (*përmes prefektit dhe/apo aktorëve të tjera të specializuar apo të interesuar*).

Qendra ÇIP shtrin tashmë ekspertizën e gjerë të akumuluar me monitorimin e botimeve zyrtare të institucioneve qëndrore kushtetuese, edhe në nivel vendor, duke shpresuar se në këtë mënyrë mbush edhe një vakum të krijuar në këto 12 vitet e fundit, që nga koha e hyrjes në fuqi të ligjit 8652, dt. 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

GERTI SHELLA

DREJTOR EKZEKUTIV
Qendra për Çështjet e Informimit Publik

PJESA E PARE

**KUADRI LIGJOR DHE
LEGJITIMITETI I MONITORIMIT**

1

KUADRI LIGJOR DHE LEGJITIMITETI I MONITORIMIT

I. VENDIMARRJA NË NIVEL VENDOR

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomisë vendore (*Neni 13 i Kushtetutës*).

Organet e qeverisjes vendore kanë të drejtë të nxjerrin akte. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksonit territorial që ushtrojnë këto organe (*neni 116 i Kushtetutës*). Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj (*Neni 120 i Kushtetutës*).

Ligji 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, normon veprimtarinë institucionale të organeve të qeverisjes vendore në RSH. Sipas këtij ligji “Organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kompeten-

cat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave” (*Neni 7, ligji 8652*). Këto lloj aktesh janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e përfshira në akt, nën juridiksonin e tyre (*Neni 8, pika “b”, ligji 8652*).

Funksioni kryesor vendimarrës në nivel vendor realizohet nga këshillat bashkiakë/komunale. Këta të fundit konsiderohen si parlamentet e qyteteve dhe ligji iu ngarkon kompetenca shumë të rëndësi-shme vendimarrëse, të tilla si caktimi i taksave dhe tarifave vendore, miratimin e buxhetit vjetor, kreditimarrje dhe grant-marrje në vlera të konsiderueshme, apo edhe vendimarje mjafit kritike mbi territorin dhe pronat që i kanë kaluar tashmë në administrim pushtetit vendor.

Në ushtrim të kompetencave të tyre, këshillat

SIPAS NENIT 32 TË LIGJIT 8652, KËSHILLI BASHKIAK KA KOMPETENCAT E MËPOSHTME:

- a) Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
- b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.
- c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit komunal ose bashkiak.
- ç) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat përkualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërbimit të punojësve dhe të personave të tjera të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjera juridikë që krijon vetë ose është bashkëthemelues.
- dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- ë) Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të komunës ose bashkisë.
- f) Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- g) Vendos përmarrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
- gi) Vendos përmarrjen e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- h) Vendos përfillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
- i) Zgjedh përfaqësuesit e këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut.
- j) Vendos përdhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.
- k) Miraton norma, standarde e kriterë përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe përmbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- l) Vendos përsimbolet e komunës ose të bashkisë.
- ll) Vendos përemërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridiksonin e komunës ose të bashkisë.
- m) Jep tituj nderi dhe stimuj.
- n) Vendos përrregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe përzbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia.

bashkiakë/komunalë nxjerrin vendime me karakter normativ dhe individual, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet nën juridikcionin e tyre. Ligji 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, normon me hollësi procesin e shqyrtimit, votimit dhe shpalljes së vendimeve të këshillave bashkiakë/ komunalë (*neni 33 i ligjit 8652*).

Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vndos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Pas ndryshimeve që pësoi *ligji 8652* në vitin 2004, parashikohet vetëm një rast kur vendimet duhet të merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, dhe kjo është konkretist në rastin kur Këshilli "miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve⁵".

NENI 33

"VOTIMI

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vndos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Vendimet, për rastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.
4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.
6. Aktet e këshillit shpalen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

II. PJESEMARRJA NË PROCESIN VENDIMARËS

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë ka përmision kryesor sigurimin e qeverisjes në nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet "respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera" (Neni 3, ligji 8652).

E drejta e pjesëmarrjes dhe informimit përfshihen në kreun "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 23 i saj përcakton shprehimisht se:

- 1) E drejta e informimit është e garantuar.
- 2) Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
- 3) Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Këto garanci kushtetuese janë transpozuar me besnikëri në dispozitat e *ligjit 8652*, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Lidhur me të drejtën e pjesëmarrjes së publikut, *neni 34* i këtij ligji përcakton shprehimisht se: *Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit* (Paragrafi 1, nen 34).

Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore (neni 35, paragrafi 2).

Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje nuk është e njëjtë gjë me *aksesin e publikut ne legjislacionin vendor*. E para implikon ekskluzivisht pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar dhe pubikut të gjerë gjatë procesit të draftimit apo shqyrtimit të projekt-akteve, me synim harmonizimin sa më të gjere të vendimarrjes, kurse e dyta implikon në shumicën e rasteve akcessin në legjislacionin vendor, ose e thënë ndryshe, njojhen efektive të publikut me vendimet e nxjerra nga Këshilli. Pjesëmarrja ndodh përpëra dhe gjatë votimit të akteve, kurse e dyta pasi procesi i shqyrtimit dhe votimit të tyre ka përfunduar. Ligivënësi ka treguar kujdes që pjesëmarrja e publikut në vendimarrje dhe garanatimi i akcessit të publikut në vendimet e marra përmes shpalljes së tyre të jenë të normuara veç e veç (*shih parashtrimet më poshtë*).

NENI 34

"MBLEDHJET E HAPURA"

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vndos për rastet kur mbledha bëhet e myllur.

III. AKSESI NË LEGJISLACIONIN VENDOR

Lidhur me shpalljen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të këshillave bashkiakë / komunalë, neni 33/6 përcakton se "Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njohimit të këtyre subjekteve që përfshihen në to."

Aktet e Këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga ky i fundit, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkates për këtë qëllim (neni 35 i ligjit 8652). Në këtë pikë, modalitetet juridike të vendimarrjes dhe ato të transparencës me publikun janë praktikisht të shkrira organikisht tek njëra tjetra (ose zgjatime të njëra tjetrës).

Zbatimi i këtyre dispozitave është kusht **juridik** dhe **faktik** për të garantuar aksesin e publikut në legjislacionin lokal, në kuptimin e njohjes efektive të tij me aktet që miraton Këshilli Bashkiak. Edhe njëherë ritheksojmë se aksesi i publikut në vendimarrjen e materializuar (*vendimet e Këshillit Bashkiak*) nuk është i njëjtë në esencë me pjesëmarrjen e publikut ne procesin paraprak të shqyrtimit të projekt-akteve të Këshillit. E para nënkupton pasjen/garantimin e mundësive efektive të njohjes me normat juridiko-administrative që cakton autoriteti vendimarrës, në rastin konkret Këshilli Bashkiak.

Konkretizimi i vendimeve në letër nga ana e ketij të fundit si dhe zbardhja dhe shpallja e tyre, përfaqësojnë materializimin e të gjithë procesit vendimarrës. Ato janë në këtë kuptim sinteza apo produkti final i këtij procesi. Edhe pse publikut mund t'i jetë garantuar pjesëmarrja (fizike) në procesin vendimarrës, në rastin kur atij nuk i garantohen mundësi efektive të njohjes me aktet ku materializohet ky proces, vetë pjesëmarrja e humbet qëllimin.

Publikimi i akteve zyrtare përbën një nga parimet themelore të qeverisjes, si në nivel qendoror ashtu edhe vendor. Ky parim afirmon kushtin që subjektit fizike dhe juridike të mund të njohin normat ligjore që nxjerrin organet qeverisëse⁶ në mënyrë që të kenë mundësi më pas t'i zbatojne ato. Për këtë arsy, ky është një shërbim publik, të cilin këto organe duhet ta ofrojnë në çmimin e kostos. Për të njëjtat arsy, publikimi i tyre është një detyrim kushtetues dhe ligjor për organet qeverisëse. Në ligjerimin teorik, kjo referohet edhe si "**informim proaktiv**" i publikut nga vetë organi që nxjerr aktin, për ta dalluar

atë nga "informimi aktiv" i cili aktivizohet nga vetë subjekti (qytetari) me anë të një kërkese që bazohet në të drejtën e tij për informim. Në rastin e kësaj të fundit, janë vetë qytetarët që kanë të drejtë⁸ të kërkojnë informacion përmes një kërkese formale e cilë depozitohet pranë organit nga i cili disponohet informacioni i synuar.

Ligji 8682, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, ka të parashikuar edhe këtë format informimi (atë aktiv) mbi aktet e që nxjerrin autoritet vendore, duke bërë referencë direkte në ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 „Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". E njëjtë dispozitë ligjore që përcakton modalitet e shpalljes dhe publikimit të akteve të Këshillit Bashkiak (eng: *proactive disclosure*), përcakton shprehimisht edhe se: "Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 „Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkates për këtë qëllim" (neni 35, paragrafi 3, fjalia e dyte)

NENI 35

SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T'U INFORMUAR

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shayrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme përrast e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji.
2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionë të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
 - 2/1. Për këshillat komunale/bashkiake janë të detyrueshme seancat e këshillimit me kryetaret dhe kryesine e fshatrave nen juridikson, ne përputhje me përcaktimet e bëra ne shkronjat "ç", "dh", "e", "f", "k" dhe "ll" të nenit 32 te ligjit. Seancat e këshillimit, ne këtë rast, shënohen ne procesverbal.
3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkates për këtë qëllim

IV. ÇFARË SYNON MONITORIMI

Nga i gjithë parashtrimi i mësipërm, është e qartë se **ligji 8652, datë 31.7.2000** "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, ka të transpozuara me kujdes disa parime të rëndësishme kushtetuese⁹, me synimin e qartë për të garantuar një proces vendimarrës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Ligjvënësi ka lidhur organikisht në dispozitat e ligjit 8652 rregullat dhe procedurën për vendimarrjen e të zgjedhurve vendorë me të drejtën e publikut për të qenë i përfshirë në këtë vendimarrje. Kjo përfshirje e publikut aktivizohet **në fillim, gjatë** dhe **në fund** të procesit vendimarrës. Konkretisht kjo nënkupton shqyrtimin paraprak të një kategorie aktesh¹⁰ me publikun e interesuar, ndjekjen e mbledhjeve në sallë teksa ato zhvillohen si dhe aksesin në vendimet e materializuara të Këshillit. Kjo e fundit garantohet si përmes informimit proaktiv (shpalljes së akteve nga vetë Këshilli bashkiak/komunal) dhe informimit aktiv (përmes referimit direkt në dispozitat e ligjit 8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare").

Nenet 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, janë mishërimi praktik i kësaj lidhjeje organike që synon garantimin e një procesi vendimarrës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Kurse nenit 33 normon në tërësi procedurën e votimit dhe mënyrën e hyrjes në fuqi (*pika 6*) të vendimeve të Këshillit. Zbatimi rigoroz i këtyre tre neneve është kusht juridik¹¹ për të patur një vendimarrje të bazuar në ligj dhe të hapur ndaj publikut.

Matja e nivelit të implementimit të neneve 34 dhe 35¹² prodhon automatikisht indikatorë të drejpdrejtë për vlerësimin objektiv të nivelit të përfshirjes së publikut në vendimarrjen lokale dhe transparencës së kësaj të fundit. Kurse matja e nivelit të implementimit të nenit 33, indikon legitimitetin e akteve dhe fuqinë e tyre juridike. Të monitorosh vendimarrjen dhe transparencën e saj në nivel vendor do të thotë të monitorosh pashtamangshmërisht nivelin e implementimit të nenit 33 të ligjit 8652. Çdo monitorim i ndërmarrë jashtë kësaj llogjike do të ish-

te një përqasje krejt jo-serioze, e paaftë për të "diagnostikuar" problemet në vendimarjen lokale.

Zhvillimi i një metode për matjen e nivelit të zbatimit të këtyre tre neneve dhe implementimi në praktikë i saj ka qenë një ndër objektivat kryesorë të këtij projekti. Kjo metodë e re monitorimi dhe vlerësimi u mor përsipër të zhvillohej nga Qendra ÇIP, në kuadër të një projekti integral i cili u implementua në dy bashki kryesore, konkretisht në Korçë dhe në Durrës. Modeli metodologjik është i tipit "**Monitorim përmes Pjesëmarrjes**¹³", ose shkurt **MP**.

Mjeti kryesor metodologjik qe u zhvilluar nga ÇIP u emërtuar **PROAKTIV** (*akronim i modifikuar për: Protokoll i Vlerësimit te Transparencës Vendimarrëse në Keshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*). Ky protokoll është *sui-generis*, që do të thotë se është "*qepur pas trupit*" të legjisacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Në vija të përgjithshme, qasja PRO AKTIV ndërthur në një bllok të vetëm **monitorimin e ligjshmërisë së procesit vendimarrës të Këshillit Bashkiak përmes pjesëmarrjes dhe raportimit aktiv qytetar**.

SHKURT MBI KËSHILLIN BASHKIAK, KORÇË

Këshilli bashkiak i Qytetit të Korcës ka 35 anëtarë. Në datën 29 qershor 2011 u mandatua Këshilli i ri Bashkiak, Korçë, i dalë nga Zgjedhjet Lokale të 8 Majit 2012. Me votim të fshehtë, anëtarët e këtij Këshilli zgjodhën me 19 vota pro z. Ilir Pendavinji në pozicionin e kryetarit të Këshillit Bashkiak Korçë, përkundrejt 15 votave të marra nga kandidati i Aleancës për Qytetarin dhe një vote abstenim. Znj. Rajmonda Nase u zgjodh zv.kryetare e këshillit bashkiak.

Në fund të mbledhjes së parë të Këshillit të ri Bashkiak të qytetit të Korcës, kryebashkiaku Niko Peleshi, ka bërë betimin e tij para Këshillit Bashkiak për një mandat të dytë katërvjecar në krye të Bashkisë Korçë.

Dokumenta të rëndësishme dhe aktorë që adresojnë problemin

1. Strategjia e Reformës Ndër-Sektoriale në Administratën Publike 2009-2013
2. Strategjia e Inovacionit dhe Qeverisjes së Mirë Vendore, Këshilli i Europës
3. Protokoli Shtesë i Këshillit të Europës për Kartën e Vet-Qeverisjes Lokale, Utrecht, 16.XI.2009.

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2009-2013

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E
REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE (SNRAP) NË
KUADËR TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM
DHE INTEGRIM**

2009 - 2013

1.4.1 Proceset administrative

Në sistemin e rishikimit administrativ konstatohet deficencë lidhur me procesin e ankimit pasi pothuajse të gjitha aktet nxirren nga titullari. Një tjetër problem ka të bëjë me faktin se vendimet normative të bashkive, degëve të ministrive etj. janë mjaft të vështira për t'u gjendur. Për më tepër, praktika tregon se haset në rezistence kur tentohet të realizohet forma elektronike e komunikimit ndërmjet institucioneve.

KAPITULLI II

2. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike

Një administratë që bazohet në procese vendimarrëse, transparente, përfshirëse dhe e përgjegjshme ndaj publikut.

2.3.2 Në nivel rajonal/vendor

Paralelisht me decentralizimin e funksioneve, të kombinuar me delegimin e vendim-marrjes dhe përdorimin e teknologjive të reja, synohet një tkurrje graduale e degëve në territor.

Shumë nga njësitë territoriale do të riorganizohen, për të kryer funksione të përbashkëta, duke racionalizuar edhe realizimin e shërbimeve të veta mbështetëse.

Në procesin e riorganizimit duhet të mbahen parasysh papajtueshmëritë e mundshme ndërmjet funksioneve të ndryshme.

2.4 Përmirësimi i procedurave dhe mjeteve të vendim-marrjes dhe kryerjes së shërbimeve në administratën publike

Në këtë drejtim ka nevojë të nxitet më tej:

- transparenca në vendimarrjen normative dhe administrative,
- zgjerimi i konsultimit publik dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjen për politikat,
- lehtësimi i përbushjes së detyrimeve administrative nga qytetarët (one-stop shop, miratimi ne heshtje),
- akses më të mirë në informacionin publik dhe në aktet administrative, përmirësimi i procedurave të ankimit administrativ brenda administratës dhe më tej në gjykatat administrative,
- Përdorimi masiv i teknologjisë moderne të informacionit dhe publikimi elektronik zyrtar i vendimeve administrative.

PJESA E DYTË

GJETJET E MONITORIMIT

2

GJETJET E MONITORIMIT

SHPJEGIM I SHKURTER MBI PJESEN E DYTË

Në këtë pjesë të dytë të Raportit ofrohen shpjegime të detajuarë për gjetjet e monitorimit të realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik (më poshtë: ÇIP), në koordinim me degën e saj lokale, Zyra për Transparancë Qytetare në Korçë (më poshtë: ZTQ).

Objekt parësor vlerësimi është niveli i zbatueshmërisë së neneve 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Sikeurse u bë e qartë në parashitrimet e mësipërme, zbatimi rigoroz i këtyre tre neneve nga Këshillit Bashkiak është kusht për të patur një vendimarrje ligjore dhe transparente. Matja e zbatueshmërisë së këtyre neneve (çdo dispozitë) çon automatikisht në matjen e nivelit të transparencës dhe ligjshmërisë në vendimarrjen lokale.

Gjetjet në këtë Pjesë të Dytë do të renditen sipas kriterit që cakton renditja e këtyre dispozitave në ligjin 8652, të ndryshuar. Më pas, në Pjesën e Tretë do të jepen në mënyrë të përmbledhur paraqitjet grafiqe të të dhënava si dhe vizualizimi i nivelit të transparencës që karakterizon vendimarrjen e Këshillit Bashkiak, Korçë, për periudhën nën monitorim (Shkurt 2011 - 30 Prill, 2012)

Ndryshe nga nenet 34 dhe 35 të ligjit 8652 të ndryshuar, zbatueshmëria e nentit 33 paraqet një interes më të ulët në kuadër të këtij monitorimi për shkak të faktit se ai targeton vetëm Këshillin dhe jo publikum dhe/ apo përfshirjen e tij në vendimarrje, që është qëllim kryesor në kuadër të kësaj iniciative. Kjo e fundit, sikeurse është bërë e qartë tashmë garantohet përmes zbatimit rigoroz të neneve 34 dhe 35 të ligjit në fjalë.

Megjithatë, të monitorosh procesin vendimarrës në nivel vendor duke anashkaluar me qëllim vlerësimin e modaliteteve ligjore të votimit të akteve nga Këshilli, do të ishte që në pikënisje një nismë

e cunguar. Jo pa qëllim, neni 33, 34 dhe 35, janë të vendosur nga ligjivënesi pranë njëri tëjetrit në ligjin 8652, të ndryshuar. Këto nene normojnë veç e veç tre fazat në të cilat kalon procesi vendimarrës në nivel vendor: 1) diskutimi paraprak i projekt-vendimeve me aktorët e interesuar dhe publikun, 2) votimi i projektvendimeve nga këshilltarët gjatë mbledhjes së Këshillit dhe 3) shpallja dhe hyrja në fuqi e vendimeve tashmë të miratuara nga Këshilli.

Nga 440 vendimet e marra gjatë 16 muajve nën monitorim, shumica dërrmuese janë me karakter individual (138). Klasifikim i vendimeve në dy kategori, me karakter individual dhe normativ është një proces i posaçëm i analizës që ushtruar nga ekspertët e Qendrës ÇIP në kuadër të hartimit të këtij raporti, pasi është kusht për të vlerësuar nivelin e zbatimit të dispozitës 33/1¹⁴ nga ana e Këshillit Bashkiak. (lexo më shumë rreth këtij argumenti tek: Metodologjia). Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se "Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë". Nga raportet periodike të hartuara nga ekipi i ZTQ, Korçë, por edhe nga vlerësimi tëresor dhe i kujdeshëm i të gjitha materialeve filmike ku janë dokumentuar mbledhjet e Këshillit Bashkiak¹⁵, rezulton se kjo dispozitë e ligjit është respektuar vetëm në shtatë raste, dhe konkretisht për vendimet nominale gjatë përiudhës së konstituimit të Këshillit të ri Bashkiak që doli pas gjedhjeve të 8 Majit 2011. Për të gjitha vendimet e tjera me karakter individual (131), këshilltarët bashkiakë kanë bërë votim të hapur. Bazuar në numrin e përgjithshëm të vendimeve me karakter individual, ÇIP ka përllogaritur edhe nivelin e zbatimit të dispozitës 33/1 të ligjit 8652 nga Këshilli Bashkiak, Korçë për 16 muajt që ka qenë nën monitorim (shiko: graf 1 & 2, fq. 47)

Cilat janë kriteret e vlerësimit për të dalluar aktin normativ nga akti individual

Akti administrativ individual rregullon në veçanti marredhenie konkrete të posaçme për një çështje të caktuar dhe ndaj një subjekti ose grupi subjektes te identifikuveshem. Edhe ne rastet kur akti administrativ i shtrin efektet e tij jo per një person te caktuar, por per një grup ose një kategori me te gjere subjektes te verifikueshme dhe identifikuveshme, karakteri i tij individual mbetet. Nese marredhenia juridike qe ai rregullon eshtë konkrete, akti nuk e humbet individualitetin e tij.

Kur me ane te një akti vendosen rregulla te detyrueshme sjelljeje per një marredhenie juridike ose per një kompleks marrëdhënie, ai konsiderohet akt i përgjithshem ose normativ. Akti ne këtë rast eshte abstrakt. Ai rregullon marredhenie ne tërësi dhe per një kategori te gjere subjektes. Akti i përgjithshem nuk i referohet një fakti konkret, por një numri faktash te mundshme ose hipotetike. Akti normativ, per te qene i njejtë per te gjithe, formulohet ne kuptimin me te përgjithshem dhe abstrakt, duke i u referuar pa asnjë lloj diskriminimi cdonjerit dhe per c,fardo lloj fakti. Ne aktin normativ perfshihen ato norma qe rregullojnë marredhenie te përgjithshme, ne dallim nga akti individual qe perfshin norma qe rregullojnë marredhenie per subjekte ose objekte.

Në mënyrë të përbledhur, mund të konkludohet mbi tre cilesi të akteve normative. Ato, janë të përgjithshme, parashikojne hipoteza abstrakte, si dhe nuk shtrohen me një akt të vetem zbatimi.

1. ZBATUESHMËRIA E NENIT 33 “VOTIMI”

Ligji 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

NENI 33 “VOTIMI”

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Vendimet, për rastet e parashikuara ne shkronjat “b”, “c”, “d”, “dh”, “g”, “gj”, “i” dhe “j” te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.
4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja “e” e këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.
6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njohimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

GJETJET E MONITORIMIT

1.1 VOTIMI I FSHEHTE I VENDIMEVE ME KARAKTER INDIVIDUAL (NENI 33/1)

Gjatë vitit 2011, Këshilli Bashkiak i Korçës ka marrë gjithsej 99 vendime. Ky është një numër më i vogël krahasuar me vitin 2010¹⁶. Ulja e produktivitetit vendimarrës në terma sasiore mund të hamendësohet se ka ndodhur për shkak se 2011 ka qenë një vit elektoral, që nënkupton ndërprejen e përkohshme të aktivitetit normal legjislativ për shkak të fushatës zgjedhore dhe të periudhës së konstituimit të këshillit të ri bashkiak.

Gjatë katër-mujorit të parë të vitit 2012 (deri në 19 Prill), Këshilli Bashkiak i Korçës ka marrë gjithsej 41 vendime. Kjo periudhë është karakterezuar nga një aktivitet mjëft i rendësishëm vendimarrës i Këshillin Bashkiak, siç është miratimi i “Paketën Fiskale 2012”, që cakton nivelin e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen nga autoritetet vendore ndaj subjekteve. Po ashtu, brenda këtij 4-mjori është diskutuar dhe votuar në Këshillin Bashkiak edhe Buxheti i Bashkisë për vitin 2012. Të dyja këto vendimarrje shumë të rendësishme do të anlizohen gjérësisht në kuadër të këtij Raporti (*shih më poshtë: Pjesëmarria e publikut në vendimarrje*). Ato janë në thelb edhe arsyesa përsë ky Raport nuk mjaftohet vetëm me analizimin e vendimarrjes për vitin 2011, por i shtuin vlerësimet e veta edhe katër muajt e parë të vitit 2012.

Nga 140 vendimet e marra gjatë 16 muajve nën monitorim, shumica dërrmuese janë me karakter individual (138). Klasifikim i vendimeve në dy kategori, me karakter individual dhe normativ është një proces i posaçëm i analizës që ushtruar nga Ekspertët e Qendrës ÇIP në kuadër të hartimit të këtij rapportit¹⁷, pasi është kusht për të vlerësuar nivelin e zbatimit të dispozitës 33/1 nga ana e Këshillit Bashkiak. (*Ilexo më shumë rreth këtij argumenti tek: Metodologjia*). Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se “Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë”. Nga raportet periodike të hartuara nga ekipi i ZTO, Korçë¹⁸, por edhe nga vlerësimi tëresor dhe i kujdesshëm i të gjitha materialevë filmike ku janë dokumentuar mbledhjet e Këshillit Bashkiak¹⁹, rezulton se kjo dispozitë e ligjt

është respektuar vetëm në shtatë raste, dhe konkretisht për vendimet nominale gjatë përiudhës së konstituimit të Këshillit të ri Bashkiak që doli pas gjedhjeve të 8 Majit 2011 (*shih tabela 1, Aneksi Nr. 1, fq. 35*).

Për të gjitha vendimet e tjera me karakter individual (131), këshilltarët bashkiakë kanë bërë votim të hapur. Bazuar në numrin e përgjithshëm të vendimeve me karakter individual, ÇIP ka përllogaritur edhe *nivelin e zbatimit të dispozitës 33/1 të ligjit 8652 nga Këshilli Bashkiak, Korçë për 16 muajt që ka qenë nën monitorim* (*grafiku 1 & 2, fq. 43*)

Anashkalimi i procedurës ligjore për votimin e fshehtë të të gjitha vendimeve më karakter individual diktohet edhe nga infrastruktura e munguar në sallën ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Prej disa vitesh tashmë, mbledhjet e Këshillit zhvillohen në sallën e leximit të bibliotekës së qytetit të Korçës. Kjo sallë e marrë “borxh” nuk ofron asnjë tjetër përvëç karrikeve dhe tavolinave. Nuk bëhet fjale për infrastrukturë elektronike votimi (*si p.sh. në rastin e Tiranës apo Durrësit*). Kjo e bën të paleverdiSSHME nga pikpamja kohore realizimin e votimit me letër sa herë që në rend të ditës për votim ka vendime me karakter individual. Në ato pak raste kur procedura ligjore është respektuar pikë për pikë sa i takon votimit të fshehtë, procesi i votimit dhe i numërimit të votave ka zgjatur mbi dy orë vetëm për një akt.

Një arsyë e dytë që mund të shpjegojë se përsë Këshilli Bashkiak në Korçë miraton përgjithësisht me votim të hapur vendimet më karakter individual, mund të ishte ndoshta njohja e paktë e dispozitave të ligjit 8552 nga vetë këshilltarët apo sekretari i Këshillit Bashkiak (neni 33/1). Në fakt kjo do të kishte qenë një “mostnjohje” tërësisht e justifikuar, po të mbahet parasysh se nuk asnjë manual, rregullore, udhëzim apo vendim gjykate që të interpretojë dhe/apo caktojë kriterë se çfarë dhe si dallohet një vendim individual nga një vendim normativ (*Ilexo më shumë rreth kësaj tek Pjesa IV, Rekomandimet*).

GJETJET E MONITORIMIT

1.2 VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME SHUMICË TË THJESHTË (NENI 33/2 & 33/3)

Nga totali i VKB për periudhën e monitoruar, vetëm një numër i vogël i tyre kanë karakter normativ (rreth 12 të tillë). Ndërsa to meriton të përmendet **Vendim nr. 13, dt. 09.03.2011** "Per nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre ne qytetin e Korçës si dhe penalitetet per shkeljet apo kundravajtjet administrative", apo edhe **Vendim nr. 44, dt. 28.07.2011** "Mbi miratimin e buxhetit te bashkisë dhe institucioneve te vartesise per vitin 2011". Ky i fundit, sikurse sugjerojnë edhe atributet e aktit, është marrë pas konstituimit të Këshillit të ri Bashkiak i cili doli nga zgjedhjet e 8 Majit 2011. Deri para kësaj date, Këshilli Bashkiak me shumicë këshilltarësh nga koalicioni PD-LSI, rrëzoit çdo tentative të kreut të ekzekutivit të Bashkisë Korçë, Niko Peleshi, për të kaluar projekt-buxhetin e përgatitur nga administrata e tij. Vlen gjithashtu të theksohet se **Vendimi nr. 44, dt. 28.07.2011** "Mbi miratimin e buxhetit të bashkisë dhe institucioneve te vartesise per vitin 2011", edhe pse u miratua nga këshilli i ri bashkiak, tanimë me shumicë këshilltarësh nga koalicioni i majtë "Aleanca për të Ardhmen", u rikthyen per nishqyrtim nga Prefekti, me arsyetimin "për shkelje ligjore në perqindjen e kontributit të Bashkise Korçë në Këshillin e Qarkut". Këshilli i ri Bashkiak i Korçës e rifiuti sërisht në procedurë votimin vendimin për Buxhetin 2011 dhe e miratoi atë me ndryshimet e kërkuar (VKB nr. 47, dt 25/08/2011).

Në të gjitha këto raste, votimi është bërë i hapur, dhe sa kohë që këto janë vendime normative, kjo është një praktikë e mbështetur në ligj. Për sa i takon periudhës 4-mujore të vitit 2012, Këshillimirato Paketën Fiskale 2012 (VKB nr. 2) si dhe Buxhetin 2012 (VKB nr. 27). Të dyja këto vendime shumë të rëndësishme iu kthyen Këshillit përrishqyrtim nga Prefekti i Korçës, A. Mano. Paketa Fiskale u kthye me arsyetimin se nuk ishin respektuar kërkesat e ligjit 8652, të ndryshuar, për konsultim paraprak të Taksave dhe tarifave vendore (Paketës Fiskale) me aktorët e interesit. Gjithsesi, në mbledhjen e datës 26 Mars, Këshilli e kaloi sërisht me votim të thjeshtë Paketën Fiskale 2012, edhe këtë herë pa ndërmarrë ndonjë konsultim me Publikun.

Edhe Buxheti 2012 u kthye gjithashtu nga Prefekti. Ai u fut për rivotim në mbledhjen e datës 18 Prill, dhe u kalua me votat e këshilltareve të majtë (shumicë e thjeshtë).

MODALITETET E VOTIMIT

Neni 33/3, përcaktion shprehimisht se *Vendimet, përrastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.*

Nga monitorimi në sallë i procesit vendimarës nga ana e Këshillit Bashkiak, Korçë, rezulton se kjo kërkese e ligjit është respektuar. *Ky rezultat derivon lehtësisht edhe nga një deduksion i thjeshtë logjik:* si në Këshillin Bashkiak të para-8 Majit ashtu edhe në atë që u konstitua pas këtyre zgjedhjeve, diferenca mes shumicës dhe pakicës përcaktohej nga vetëm nga fare pak vota, dhe, përsë kohë që kemi të bëjmë me vendime të miratuara, fjalë vjen për Buxhetin, Paketën Fiskale, etj, kjo shtyn apriori në konluzionin

NENI 32

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

Këshilli komunal ose bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
- b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zv. kryetarin e këshillit
- c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak.
- c) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkosat përkualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërbimit të punonjësve dhe të personave të tjera të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjera juridikë që krijon vetë ose është bashkëthemelues.
- dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetësimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- f) Organizon e mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë.
- f) Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- g) Vendos marrje kredish dhe shlyerjen e detyrimeve të tretëve.
- gi) Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshiri subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- h) Vendos përfillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
- i) Zgjedh përfaqësuesit e vet në këshillin e qarkut.
- j) Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.
- k) Miraton norma, standarde e kriterë përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- l) Vendos përsimbollet e komunës ose të bashkisë.
- ll) Vendos përemtimin e rrugëve, të sheshave, të territorave, të institucioneve dhe të objekteve në juridikacionin e komunës ose të bashkisë.

që dispozita 33/3 e ligjit 8652 është plotësishët e zbatuar, pasi në rast të kundërt, nuk do të kishte patur një vendimarje për to.

Ndërkohë, bazuar në të dhënat e reportuar nga anëtarët e ZTO, Korçë, por edhe nga vlerësimi në vend i bërë nga stafi i ÇIP i cili gjithashtu ka ndjekur here pas here mbledhjet e Këshillit Bashkiak Korçë, rezulton se, në përgjithësi vendimet janë marrë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kjo e dhënë çon në përfundimin se pika 2 e nenit 33 të ligjit 8652 të ndryshuar është zbatuar rigorozisht gjatë vendimarrjes në sallën e mbledhjeve të Këshillit.

GJETJET E MONITORIMIT

1.3 VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME TRE TË PESTAT (NENI 33/4)

Ligi 8652, i ndryshuar, parashikon vetëm një rast vendimarrje për të cilën nevojiten 3/5 e votave të tē gjithë anëtarëve të Këshillit. Neni 33, përcakton në pikën 4 të tij se "Vendimet merren me tre tē pestat tē numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja „e“ e këtij ligji", ose e thënë ndryshtë, në rastet kur Këshilli miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve¹⁹.

Gjatë vitit 2011, Këshilli Bashkiak i Korçës ka marrë 8 vendime për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Kurse, gjatë katër-majorit të parë të vitit 2012, Këshilli Bashkiak i Korçës ka marrë gjithsej 7 vendime të këtij lloji (Tabela 2, Aneksi 1, fq. 35). Në të 15 rastet e vëzhguara, votimi ka qenë pothuajse unanim. Kjo do të thotë se nenii 33, pika 4 e ligjit 8652 është respektuar

plotësisht sa i takon kuorumin ligjor për votimin e aktit.

Megjithatë, në rastin e këtyre vendimeve, duhet bërë një vlerësim i dyfishtë sa i takon respektimit të dispozitave ligjore të votimit. Kujtojmë këtu që këto vendime janë me natyre të pastër individuale, pasi i referohet një fakti konkret dhe nëpërmjet këtyre akteve nuk vendosen norma të përgjithshme dhe abstrakte¹. Neni 33/1 përcakton shprehimisht se "Aketet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë".

Nga të dhënat e raporteve periodike të depozituara nga ZTO Korçë, por edhe nga vëzhgimi i kujdeshëm i të gjitha materialeve audio-video te mbledhjeve të Këshillit, ÇIP ka konkluduar se në asnjë prej rasteve të listuara më sipër, nuk është bërë votim i fshehtë nga këshilltarët.

GJETJET E MONITORIMIT

1.4 SHPALLJA DHE HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (NENI 33/6)

Sikurse është shpjeguar edhe më sipër, *ligji 8652, i ndryshuar*, ka bërë përcakttime të qarta lidhur me procedurën e shpalljes dhe hyrjes në fuqi të Vendimeve të Këshillave Bashkiakë. "Aketet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aketet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofimit të tyre subjekteve që përfshihen në to"(neni 33/6)²⁰.

Ligjvënësi është kujdesur të dallojë qartë përmes kësaj dispozite momentin e miratimit të aktit nga momenti i shpalljes së tij. Shpallja në këtë rast nënkuption njoftimin e vendimit subjekteve të interesuara, pasi vëtë këshillarët janë të njojur me vendimin në fjalë që në momentin që e kanë miratuar atë. Akti administrativ konsiderohet se i është njoftuar nga autoriteti shtetëror subjekteve të interesuara nga momenti i kryerjes së atyre veprimeve që kërkon ligji përt'u quajtur akt i shpallur²¹.

Përcaktimi paraprak i karakterit normativ apo individual të aktit (vendimi i Këshillit Bashkiak) është i domosdoshëm edhe në këtë rast, si kusht për të vlerësuar objektivisht modalitetet e ndjekura për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të Këshillit Bashkiak.

SHPALLJA E AKTIT

Nga vlerësimi që ÇIP ndërmori, rezulton se vendimet e Këshillit Bashkiak, Korçë janë një "kakofoni" sa i takon modaliteteve të shpalljes dhe hyrjes në fuqi. Rezulton se

asnë nga 140 vendimet e nxjerra në 16 muaj monitorim nuk ka të përcaktuar shprehimisht në trupin e aktit datën në të cilën shpallojnë. Sipas përcaktimit ligjor, *aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre*. Kjo do të thotë se afati në dispozicion të Këshillit për të shpallur të firmosura dhe të vulosura vendimet e miratuara është jo më shumë se 10 ditë.

Përtakuptuar më mirë: Këshilli merrnë shqyrtim për miratim (ose jo) në seancë plenare projekt vendime. Nëse miratohen, ato kthehen në vendime të Këshillit. Nga ky moment, Sekretari i Këshillit Bashkiak riformulon tekstin e vendimit (i cili mund të ketë pësuar mjaft ndryshime gjatë diskutimeve në seancë) dhe ia dërgon për firmosje kryetarit të Këshillit (ose në mungesë, nën kryetarit). Më pas vendimi vuloset. Vetëm pas mer këtë formë përfundimtare, ai quhet formalisht një vendim i Këshillit Bashkiak. Ky proces zgjat nga 1 deri në 3 ditë si rregull. Megjithatë, ligjvënësi i ka lënë në diapozicion Këshillit 10 ditë për të realizuar shpalljen e aktit. Vendimi, i cili tashmë është i zbardhur, i firmosur dhe i vulosur, mund të konsiderohet i shpallur. Njëkohësisht ai i dërgohet Prefektit për kontrollin e ligjshmërisë së tij. Ky i fundit duhet të shprehet përligjshmërinë e aktit brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të tij në Prefekturë (Neni 14, pika 2/b, Ligji Nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për Prefektin").

Sa për ilustrim, kjo është një praktikë normale që ndiqet, fjala vjen, në Këshillin Bashkiak Durrë. Në trupin

e vendimit të KB Durrës gjenden të përcaktuar qartë data e shpalljes së vendimit, e cila nuk është e njëjtë me datën e mbledhjes (shkon nga 1 deri 5 ditë pas datës së mbledhjes). Më pas, në një fjalë të dytë përcaktohet edhe mënyra e hyrjes në fuqi të vendimit (menjëherë, ose pas 10 ditësh).

Pra, fjalia e parë e paragrafit 6 të nenit 33 ka në fakt dy dispozita. E para është që "Aktet e këshillit shpalallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre" dhe e dyta që "aktet hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes".

Sa i takon të parës, asnjë nga 140 vendimet nuk ka të përcaktuar në trupin e tij momentin e shpalljes së tij.

HYRJA NË FUQI

Lidhur me hyrjen në fuqi, vihat se 39 vendime, nga një 140 gjithsej, janë përcaktuar që të hyjnë në fuqi menjëherë. Këtu përfshihen edhe vendime normative, të cilat, për nga vetë natyra, kanë nevojë për pak kohë që të njihen në mënyrë që të zbatohen më mirë. Të tillë vendime normative janë psh.:

i Prefektit. Nëse aktet do të hynin në fuqi menjëherë, atëherë lind pyetja: çfarë do të ndodh me afektet e gjeneruara menjëherë nga vendime të këtij tipi, kur Prefekti do të rikthente për rishqyrtim në Këshill? A do të ishin këto efekte tashmë të kthyeshme?

Ligji Nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për Prefektin", në nenin 14 "Verifikimi i ligjshmërisë së akteve" përcakton shprehimisht në pikën 1 të tij se: Zbatimi i akteve të organeve të qeverisjes vendore bëhet në përputhje me pikën 6 të nenit 33 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar. Kjo pikë, nuk parashikon asnjë rast të hyrjes në fuqi menjëherë të vendimeve të Këshillit Bashkiak.

I vetmi rast (ekstra-ligjor) kur një vendim mund të caktohet të hyjë në fuqi menjëherë është atëherë kur zgjidhet kryetari i këshillit (mbledhja e parë e konstituimit), sa kohë që ky i fundit duhet të firmosë me autoritetin e tij vendimet e mbledhjes së parë të Këshillit të sapo-konstituuar. Por, në rastin e Korçës, ky në fakt ka qenë një vendim i cili u përcaktua të hynte në fuqi 10

Vendim nr. 13, dt. 09.03.2011 "Per nivelin e taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Korces si dhe penalitetet per shkeljet apo kundravajtjet administrative"

Vendim nr. 47, dt. 25.08.2011" Per rishqyrtimin e VKB Dr. 44 date 28.07.2011 "Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe Institucioneve te vartesise per Vitin 2011"

Vendim nr. 86, dt. 25.11.2011" Mbi miratimin e sistemit te pikezimit per formularet e banesave sociale me qera"

Vendim nr. 2, dt. 13.02.2012 "Per nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre ne qytetin e korçës si dhe penalitetet per shkeljet apo kundravajtjet administrative "

Ndërkojë, 8 vendime nuk kanë fare të përcaktuara në akte momentin e shpalljes së tyre.

Hyrja në fuqi menjëherë e vendimeve të Këshillit Bashkiak është një procedurë e cila nuk përshtruhet në pikën 6 të nenit 33. Kjo edhe për arsyen se të gjitha aktet që nxjerr këshilli, duhet që, para se të hyjnë në fuqi, të kalojnë më parë "filtrin e ligjshmërisë" tek institucioni

ditë pas shpalljes. Edhe në një rast të tillë, përcaktimi më korrekt do të duhet të ishte:

"Shpallet sot më: (data e mbledhjes) dhe hym në fuqi menjëherë pas miratimit nga Prefekti"

Kjo në fakt do të duhet të ishte një normë e standartizuar **në ligjin 8652, të ndryshuar**, dhe meriton të rishikohet në kuadër të amëndimeve të mundshme.

Paradoksi i kryetarit të Këshillit

Në mbledhjen e datës 29.06.2011, Këshilli i ri Bashkiak, i dalë nga zgjedhjet vendore të 8 Majit, zgjodhi organet e veta drejtuese. Me vendim nr. 28, dt. 29.06.2011 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", z. Ilir Pendavinji u zgjodh kryetar i Këshillit Bashkiak, Korçë me shumicë votash nga anëtarët e koalicionit të majtë "Aleanca për të Ardhmen". Vendimi përcakton në dispozitën e fundit të tij se "hym në fuqi 10 ditë pas shpalljes".

Në të njëjtën mbledhje, janë marrë edhe dy vendime të tjera me karakter individual, konkretisht ai me nr 29 dhe me nr 30, të cilët zgjedhin respektivish nën kryetarin e Këshillit dhe anëtarët e Këshillit të Qarkut. Edhe këto vendime përcaktohen se hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes, edhe pse personat të cilëve këto vendime ju adresohen janë prezent në sallë (kanë marrë menjëherë dijeni mbi rezultatin e votimit). Për më tepër, këty dy vendime të fundit janë firmosur nga Kryetari i Këshillit Ilirjan Pendavinji, në cilësinë e kryetarit të Këshillit. Në fakt, ai mund të firmosë këto vendime në këtë cilësi vetëm pas 10 ditësh, kohë kjo e domoshshme sipas përcaktimit të vetë VKB nr. 28 për hyrjen në fuqi. E thënë ndryshe, z. Ilir Pendavinji është kryetari i Këshillit Bashkak de-jure vetëm pas datës 7 Korrik, 2011 dhe jo që në datën 29 Qershor 2011, kur janë firmosur prej tij, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të sapo konstituuar VKB nr. 28, 29 dhe 30.

Ky paradoks mund të ishte elemiuar nëse juristët e bashkisë do të kishin proceduar sipas përcaktimit ligjor, dmth duke caktuar që vendimet në fjalë të shpallen dhe të hymin në fuqi menjëherë (pasi ato janë me karakter individual dhe për më tepër, subjektit të cilëve ju drejtohen ky akt kanë marrë menjëherë dijeni për shkak të prezencës së tyre në sallë). Ky paradoks procedural duhet adresuar permes amendimit të nenit 26 të ligjit 8652, të ndryshuar, i cili normon modalitetet e zgjedhjes së Kryetarit, zv. Kryetari dhe anëtarët që përfaqësojnë Këshillin në nivel Qarkut

Por, sa i takon vendimeve me karakter të pastër normativ, siç është Buxheti apo Taksat dhe Tarifat vendore (Paketa Fiskale), në asnjë rast ato nuk mund të futen në fuqi menjëherë, siç është vepruar në Korçë. Lidhur me **Vendimin nr. 2, dt. 13.02.2012** "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre në qytetin e korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative", janë konstatuar komplikacione edhe më të rënda, që kanë të bëjnë direkt me modalitetet e hyrjes në fuqi të vendimit. Gjatë monitorimit, ZTQ Korçë raportoi ankesa në rritje të qytetarëve për aplikimin e tarifës së re të furnizimit me ujë, në një kohë që Paketa Fiskale 2012 nuk ishe miratuar akoma nga Këshilli. **VKB nr. 2** madje u kthye nga prefekti për mangësi ligjore në vendimarrje e Këshillit. Ky i fundit e rivotoi Paketën Fiskale vetëm në mbledhjen e datës 26 Mars 2012. Tarifa për ujin urrit ndjeshëm në raport me vitin 2011. Aplikimi i saj para se të Këshilli ta miratonte atë apo tekxa vendimi nuk kishte hyrë akoma në fuqi, duhet konsideruar një problem serioze, për të mos thënë një shpërdorim detyre.

HYRJA NË FUQI E AKTEVE ME KARAKTER INDRIVIDUAL

Neni 33, pika 6 përcakton shprehimisht se "Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofimit të tyre subjekteve që përfshihen në to". Kjo dispozitë mbart komplikacione jo vetëm për t'u monitoruar, por edhe për aplikimin e saj korrekt në praktikë, duke përashtuar ndoshta vetëm rastet e vendimeve nominale që merren gjatë periudhës së konstituimit. Gjatë periudhës nën monitorim, Këshilli Bashkiak, Korçë ka nxjerrë vendime me natyrë individuale, të cilat përfshijnë një numër të madh subjektesh në to, si janë psh. vendimet për përcaktimin e listave që përfitojnë kredi të buta për

strehim. Ky vendim me natyrë individuale, përvçe të eshtë kthyer disa herë për rishqyrtim dhe plotësim me emra të rinj, do të sillte një humbje të pallogaritshme kohe nëse do të hynte në fuqi në momentin kur do të përfundonte njoftimi një për një i të gjithë subjekteve (disa dhjetëra). Prandaj, modalitetet e njoftimit të vendimit tek subjektet që përfshihen në të nuk do të përllogatitet si një variabël më vetë në vlerësimin e zbatueshmërisë së pikës 6 të nenit 33. Për më tepër, Qendra ÇIF rekomanodon heqjen e fjalisë së dytë nga pika 6 e nenit 33 (*shih: Rekomandim VII*).

VENDI I SHPALLJES

Në kuadër të vlerësimit të dispozitave të nenit 33/6, përsa i takon *shpalljes dhe hyrjes në fuqi të vendimeve*, është i domosdoshëm jo vetëm vlerësimi i kohës së shpalljes së aktit apo kohës brenda së cilës akti i shpallur hyn në fuqi, por edhe *i vendit* në të cilin aktet e shpallura eksposozhen për të marrë fuqi.

Por, këtë procedurë, ligjvënësi e ka normuar pak më poshtë, në nenin 35, pika 3, kur thotë shprehimisht¹ se: "Akitet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre". Rrjedhimisht, shpallja përmes afishimit apo publikimit diku (*vendi*), do të jenë pjesë e vlerësimeve të nenit 35 më poshtë.

Në kuadër të vlerësimeve në këtë seksion, ÇIP kon sideron se shpërndarja në dy nene, konkretisht në nenin 33/6 dhe 35/3, e modaliteve që janë të domosdoshme për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të një vendimi (*koha, vendi*), është një pakujdesi teknike e ligjvënësít, e cila, sikurse provohet edhe nga gjetjet, nuk i ka shërbyer mirë implementimit korrekt të tyre (*Shih për më shumë Rekomandimi III, fq. 56*).

KONSIDERATA EXTRA PER TITULLIN "QYTETAR NDERI"

Vlen të përmenden në këtë kontekst i vlerësimave përta i takon votimit të fshehtë të vendimeve me natyrë individuale, mosmarrveshjet e thella të vërejtura në rastin e votimit nga Këshilli të propozimit të ekzekutivit të Bashkisë për emërtimin e një rruge me emrin "Myftar Grabocka", një prej emrave të njohur të ish nomeklaturës komuniste në Qarkun e Korçës (Myftar Grabocka, është babai i regjizores së njohur Vera Grabocka). Këshilltar demokrat Pëllumb Begiri e kundërshtoi me forcë propozimin e Bashkisë, bazuar në pretendimin se Grabocka ka qenë pjesëtar i ish-nomeklaturës komuniste, Shqipëri. I menjëherëshëm ka qënë reagimi i zotit Peleshi i cili tha se vlerësonte disa prej punëve publike si, mbyllja e lumit që shkonte përmes qytetit, ndërtimi i parkut "Rinia" etj. Po ashtu, debate të ngjashme kanë përfshirë këshilltarët bashkakë edhe për votimin e propozimit për dhënien e titulli Qytetar nderi Z. Behxhet Pacolli, i cili, sipas atyre që e kundërshtuan fugishëm këtë propozim, nuk ka asnjë lidhje me qytetin e Korçës.

Në të dyja rastet e sjella për ilustrim të problemit, këmi të bëjmë me vendime me karakter individual. Në të dyja rastet kanë lindur debate të forta. Në të dyja rastet vendimarja është realizuar e hapur dhe vendimi ka kaluar vetëm me votat e forcës politike që ka shumicën në Këshill Bashkiak (e majta) edhe pse është e vështirë të besohet se 17 këshilltarë të shumicës në këshill bashkiak kanë mendim unanim, fjalë vjen për z. Pacolli. Nëse do të ishte respektuar kërkesa e ligjore për votim të fshehtë, vendimarrja mund të kishte qenë ndryshe. Ky është vetëm një ilustrim i faktit se vendimarrja e hapur, në vend që risë kohezin e grupit për cështje të qytetit, gjerrjen kohezionin e komunitetit të përfaqësuar në këshill prej përfaqësuesve të tyre. Ky rast është tregues se votimi i hapur për vendime individuale ka ngarkesë të lartë "influece partiake", kur në fakt, betimi i këshilltarëve bëhet në emër të qytetarëve dhe të respektit ndaj kushtetutës dhe ligjit.

2. ZBATUESHMËRIA E NENIT 34 "MBLEDHJET E HAPURA"

Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

NENI 34

MBLEDHJET E HAPURA

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e myllur.

GJETJET E MONITORIMIT

2.1 MBLEDHJET E HAPURA (NENI 34/1)

Një ndër synimet kryesore të monitorimit ka qenë testimi dhe vlerësimi konkret i të drejtës së qytetarëve për t'u pjesëmarrë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Korçë. Kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore (*shih parashitimet tek: Legjitimiteti*). Një ndër funksionet themelore të Zyrës së Transparencës Oytetare, që ngriti Qendra ÇIP në Korçë, ka qenë pikërisht pjesëmarrja sistematike si vëzhgues në seilën mbledhje të Këshillit Bashkiak për të testuar direkt respektimin e të drejtës së pjesëmarrjes. Pjesëmarrje e ekspit të ZTQ ka qenë e garantuar në çdo, madje edhe e mirepritur.

I njëjtë vlerësim mund të bëhet edhe për pjesëmarrjen e qytetarëve të tjerë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Korçë, e cila garantonet rregullisht. Pothuajse gjatë gjithë mbledhjeve që janë zhvilluar gjatë periudhës që mbuloi monitorimi, ka patur qytetarë në sallë të cilët janë lejuar të adresojnë problemet e tyre para këshilltarëve (*shih përmë shumë detaje video-arkiva e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Korçë: http://www.infocip.org.al/?page_id=269*). Pjesëmarrja e qytetarëve direkt në diskutimet e Këshillit Bashkiak Korçë është një tipar karakteristik i jetës publike në qytetin e Korçës. Në qytete e tjera, si psh. në Tiranë dhe në Durrës, pjesëmarrja direkte e qytetarëve në mbledhjet e Këshillit është një praktikë rudimentare.

Gjatë periudhës kohore që mbuloi ky monitorim, të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Bashkiak kanë qenë me dyer të hapura. Diskutimet e mbledhjes janë pasqyruar sistematikisht dhe me interesim si nga media lokale ashtu edhe kombëtare. Nga monitorimi i ÇIP rezulton se asnjë mbledhje e Këshillit Bashkiak

Korçë nuk i ka shpëtuar mbulimit mediatik. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, diskutimet në Këshillin Bashkiak për çështje që lidheshin kryesisht me ndërrhyrje urbanistike pjesore në qytet kanë qenë objekt i shpeshtë raportimi të zgjeruar në median kombëtare (Top Channel dhe TV Klan). Media lokale, përsye të kuptueshme, i kanë dhënë minutazh shumë herë më të madh aktivitetit të Këshillit Bashkiak.

Mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar të gjitha në sallën e leximit të bibliotekës së qytetit, me përashtim të mbledhjes së datës 17 Maj 2011, e fundit për mandatin 2007-2011. Vetë Bashkia Korçë akoma nuk ka ndërtuar apo përshtatur një sallë plenare të mirfilltë për Këshillin e vet Bashkiak. Infrastruktura e sallës "së marrë borxh", në të cilën zhvillon mbledhjet Këshillit Bashkiak ka mundësi të kufizuara akomodimi për qytetarë të cilët do të kishin një interes për të ndjekur në sallë diskutimet e këshilltarëve. Një situatë e tillë kompromenton disi materializimin në praktikë të garancisë kushtetuese¹ në RSH sipas së cilës "Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive" (nieri 23/3 i Kushtetutës). Problemet me natyrë infrastrukturore të sallave të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak janë të përhapura në Shqipëri. Korça është njëra prej tyre. Ky mund të interpretohet si një tregues i kujdesit të pakët që tregohet për infrastrukturën e proceseve vendimarrëse në nivel vendor. **Megjithatë, sa i takon respektimit nga vetë Këshilli Bashkiak të dispozitës 34/1 të ligjit 8652, e testuar direkt nga vetë ÇIP dhe ZTQ në kuadër të këtij monitorimi, mund të thuhet se aksesi për të ndjekur në sallë mbledhjet ka qenë ka qenë i plotë.**

KONSIDERATA EXTRA

Kryetari i Bashkisë, Korçë ka qenë prezent në shumicën dërmuese të mbledhjet e Këshillit Bashkiak të zhvilluara në kohën e mbuluar nga ky monitorim. Anëtarët e ZTQ konstatojnë se kryerari i bashkisë ka luajtur një rol protagonist në mbledhjet e Këshillit Bashkiak si në kohën kur shumica në Këshilli i takonte koalicionit të djathtë (para 8 Majit 2011) ashtu edhe kur shumica u rimor nga këshilltarët e koalicionit të majtë (Aleanca për të Ardhmen). Kryetari i Bashkisë është përfshirë vazhdëmisht në komunikimin pyetje-përgjigje me këshilltarët bashkiakë. Një pjesë e anëtarëve të ZTQ mendojnë se prania pothuajse e përhershme e qytetarëve të cilët merrnin pjesë në mbledhjet e Këshillit për të adresuar shqetësimet e tyre, lidhet më së shumti me prezencën e kreut të ekzekutivit të Bashkisë në këto mbledhje se sa me vetë Këshillin si institucion vendimarrës i qytetit. Përgjithësisht, një pjesë e konsiderueshme e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Korçë janë zhvilluar si një dialog mes Kryetarit të Bashkisë dhe një apo dy këshilltarësh të djathtë, ose si një dialog mes kryetarit të Bashkisë dhe qytetarëve në nevojë për ndihmë sociale apo strehim. Vetë Këshilli Bashkiak mban një profil të ulët protagonisti si institucion kryesor vendimarrës i qytetit.

Video-arkiva e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Korçë

Për të adresuar efektivisht për zgjidhje problemin e ndjekjes së mbledhjeve, ÇIP ndërmori një proces relativisht të komplikuar për ndërtimin e një videoarkive online, në të cilën të aplodoheshin të gjithë mbledhjet e Këshillit, për t'i dhënë në këtë mënyrë gjithsesicil mundësi për të ndjekur procesin vendimarrës të këshillit. Ajo është një materilizim konkret i aplikimit të teknologjive të reja të informacionit në promovimin e transparencës vendimarrëse në nivel vendor.

Qytetarët e Korçës patën mundësi që të ndjekin e mbledhjet e Këshillit Bashkiak edhe online gjat kohës së këtij projekti, përmes faqes së Qendrës ÇIP, www.infocip.org, e linkuar tashmë në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli i ri Bashkiak si ai pararendes, ashtu edhe ai që doli pas zgjedhjeve të Majit 2011, janë filmuar nga Qendra ÇIP dhe më pas janë uploaduar online në një video-arkivë moderne. Kjo qasje krejt unike i jep një dimension të ri transparence veprimtarisë vendimarrëse të Këshillit Bashkiak, Korçë, duke e bërë atë kështu, bashkë me Durrësin, të vetmen bashki në Republikën e Shqipërisë, që disponojnë video-arkive online të aktiviteteve vendimarrëse. Kjo video-arkive e bën Këshillin Bashkiak Korçë edhe një lider në rajon sa i takon promovimit të transparencës në vendimarrje përmes teknologjisë të reja të informacionit.

Dokumentim rigoroz në audio-video i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Korçë është shumë i rëndësishëm edhe për vlerësimin prej cilitdo të interesuar të modalitetave ligjore të vendimarrjes në nivel vendor. Kjo video-arkive përfaqëson një vlerë të shtuar të projektit që CIP implementoi në Korçë. Videoarkiva përban të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, që nga muaji Shkurt 2010 e deri ne muajin Prill 2012.

Për më shumë shiko: http://www.infocip.org/al/?page_id=271

GIETJET E MONITORIMIT

2.2 NJOFTIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (NENI 34/2)

Neni 34, pika 2 përcakton shprehimisht se "Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dli në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes."

NJOFTIMI NË NË VENDE TË CAKUARA NGA KËSHILLI

Në portën kryesore të godinës së Bashkisë Korçë, është e vendosur një stende tek e cila presupozohet të afishohen akte të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, gjykata e rrëthit, etj. Kjo stendë ka qenë objekt konstant monitorimi nga ana e ZTQ, Korçë. Për të dokumentuar plotësisht rezultatet, kjo stendë është fotografuar pothuajse çdo ditë gjatë periudhës së këtij monitorimi. Në asnjë prej rasteve nuk është konstatuar afishimi qoftë edhe i një njoftimi të vetëm për datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së rradhës së Këshillit Bashkiak. Anëtarët e ZTQ nuk kanë konstatuar dhe as kanë raportuar për ndonjë stende të dytë, në ndonjë hapësirë tjetër publike në Korçë, që të ketë shërbyer për të afishuar njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Bashkia Korçë ka gjithsesi një zyrë informacioni e cila, si rregull, merr dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjeve. Megjithatë, në kuadër të monitorimi, metoda e përdorur nuk parashikon vlerësimin e performancës së kësaj zyre apo edhe vlerësimin mbi bazë ditore të personave të cilët mund të jenë drejtuar në këtë zyrë për të marrë dijeni mbi mbledhjetë radhës të caktuara nga Këshilli Bashkiak. Edhe pse informimi i publikut përmes kësaj zyre mund të konsiderohej i mirëqenë, kjo nuk mjafton që i njoftimi përmes kesaj zyre të jetë një variabel më vete në grafikun e nivelit të implementimit të paragrafit 2 të nenit 34 (graf. 10, fq.48), pasi ai nuk mund të konsiderohet "njoftim proaktiv".

NJOFTIMI NË MEDIA

Në Korçë zhvillojnë aktivitetin e tyre 3 televizione lokale. Ato kanë një programacion të larmishëm si dhe një audience të konsoliduar në Korçë. Këto televizione prodhojnë një "klimë të shëndetshme" mediatike në rajojin juglindor. Problematikat ekonomike dhe sociale zënë një vend të konsiderueshmë në kronikat televizive dhe edicionet e lajmeve që përgatitin këto televizione. Pushteti vendor gjithashtu zë nië hanësirë të konsiderueshme

Përgjithësisht, çdo mbledhje e Këshillit Bashkiak ka gjetur pasqyrim të bollshëm në kronikat televizive në të treja televizioni.

Sa i takon njoftimit paraprak të mbledhjeve, sipas kuptimit të nenit 34/2, ZTQ ka raportuar vetëm **6** raste njoftimi për një total prej **19** mbledhjesh të Këshillit Bashkiak Korçë të zhvilluara gjithsej gjatë periudhës nën monitorim. Nuk rezulton gjithsesi që të ketë një praktikë të përhershme, që të ndiqet konform një protokolli të caktuar nga Këshilli Bashkiak për njoftimin e mbledhjeve të tij. Me sa duket, qytetarët korçarë interesohen drejtëpërdrejt vetë për të marrë vesh datat e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

NIOETIMI ME MËNYRA DHE MIETE TË TIERA.

Një ndër mënyrat e mundshmë të njoftimit të mbledhjeve mund të jetë edhe përmes internetit. Bashkia e Korçës ka një faqe zyrtare interneti e cila ofron vazhdimisht informacione mbi aktivitetet e bashkisë. Nga vëzhgimi sistematik që ÇIP i ka bërë kësaj faqjeje gjatë periudhës që mbulan monitorimi, nuk rezulton që ajo të jetë përdorur

ndonjëherë për të publikuar njoftime lidhur me datën, orën dhe axhendën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ka vetëm dy njoftimi gjithsej që janë postuar për këtë qëllim në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, por ato i takojnë vitit 2010, periudhë e cila del jashtë fokusit të këtij monitorimi. Këto janë edhe të njoftimet e vetme që gjenden këtë faqe.

TELEFON EMAIL

Një praktika e ndjekur nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak Korçë për njoftimin e mbledhjeve ka qenë përmes konktaktimit kryesisht me telefon, por edhe emailit, të këshilltarëve apo të personave të tjerë të interesuar. Qendra ÇIP, si dhe të ZTQ Korçë janë njoftuar rregullisht tre katër ditë para, për mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo praktikë, edhe pse ka garantuar normalisht ndjekjen në sallë të mbledhjeve prej ekspert monitorues, ka limitet e veta objektiva për të ofruar njoftimin e të të gjithë të interesuarve të mundshëm për të ndjekur mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

2.2.4 DATA, VENDI, ORA DHE RENDI

I DITËS I MBLEDHJES SË KËSHILLIT

Një tjetër përcaktim i nëniti 34, pika 2, e ligjit 8652, të ndryshuar është edhe se "Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes" (fjalia e dytë e nenit 34/2).

Nga vlerësimi i të gjithë njoftimeve të shpërndara gjatë periudhës nën monitorim, rezulton se kjo kërkesë e ligjit ka qenë tërësisht e respektuar.

www.bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=121

Njoftohen të gjithë të rinjtë që kanë mbaruar studimet e larta, të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij projekti që synon nxjehen e iniciativave sipërmarrëse të të rinjve.

Idetë më të mira të biznesit si dha biznesplanet e paragitura do të vlerësohen nga një komision profesional dhe fituesit e projektit do të përfitojnë:

- Grand për çeljen e biznesit të tyre
- Lehtesi fiskale për biznesin gjatë vitit të pare të aktivitetit

në vazhdim...

Ftesë Festa e lakrorit

Edhe gjatë 2010-ës, Bashkia Korçë, me mbështetjen e bisnesit lokal, organizon për të tretin vit Festën e lakrorit. Ejani të shijoni lakrorin në saç, traditë e spikatur e Rajonit të Korçës, së bashku me produktet e tjera të traditës sonë. Festa do të zhvillohet ditën e shtunë, në datën 24 korrik, tek sheshi i Parkut "Rinia", në orën 18:00.

Ju presim të festojmë së bashku!

takimi i Avokatatit të Popullit me qytetarët e Korçës

Në ushtrim të funksioneve të përcaktuara nga ligji dhe në kuadër të përbushjes së veprimitarës së tij për takimin e qytetarëve sa më pranë vendbanimit të tyre, Avokati i Popullit do të zhvillojë në qytetin e Korçës një ditë të hapur për pritjen e ankesave të qytetarëve.

në vazhdim...

MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK 4 maj 2010

Diten e marte, date 04.05.2010, ora 9.00 ne Biblioteken "Thimi Mitko" Korce do te zhvillohet Mbledhja e Këshillit Bashkiak Korce me kete Rend dite:

në vazhdim...

Mbledhja e Këshillit Bashkiak prill 2010

Lajmerohen qytetaret se diten e merkurë, date 14.04.2010, ora 9.00 ne Biblioteken "Thimi Mitko" Korce do te zhvillohet Mbledhja e Këshillit Bashkiak Korce me kete rend dite...

në vazhdim...

Shpallje konkurimi per vende te lira pune Maj 2010

GJETJET E MONITORIMIT

2.3 MBLEDHJET E MBYLLURA (neni 34/3)

Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos përrastet kur mbledhja bëhet e mbyllur (Neni 34/3).

Gjatë periudhës kohore që mbulon ky monitorim, të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli kanë qenë me dyer të hapura. Nuk ka patur në asnjë rast votim për të zhvilluar seanca plenare më dyer të mbyllura. Rrjedhimisht, dispozita 34/3 nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuadër të këtij vëzhgimi, sa kohë që nuk ka patur në asnjë rast implementim të saj në praktikë.

Gjatë kësaj periudhe dy-vjeçarë që Qendra ÇIP është duke punuar në nivel vendor, nuk është konstatuar në asnjë rast të vetëm zhvillimi i ndonjë mbledhje me dyer të mbyllura nga Këshilli Bashkiak, e cila të fuste në veprim këtë dispozitë (34/3).

Rekomandim:

Qendra ÇIP vlerëson se dispozita 34/3 kontradikton me vetë frymës që mbart në të vërtetë ligji 8652, për një vendimarrje të hapur dhe me pjesëmarrje. Do të mjaftonte vetëm aplikimi rigoroz i votimit të fshehtë për të superuar çdo "përkujdesje" që dispozita në fjalë mundohet t'i sigurojë procesit vendimarrës. ÇIP rekomandon abrogimin e kësaj dispozite në kuadër të një amendimi të mundshëm që mund të pësojë në të ardhmen ligji 8652.

3. ZBATUESHMËRIA E NENIT 35 “SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T’U INFORMUAR”

Ligji 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar

NENI 35

SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T’U INFORMUAR

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme përrastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat “dh”, “e”, “f” dhe “k” të këtij ligji.
2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionet e interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
3. Aktet e këshillit qfisohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qellim.

GJETJET E MONITORIMIT

3.1 KËSHILLIMI ME BASHKËSINË (neni 35/1 dhe 35/2)

Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë (Neni 35/1). Seancat e këshillimit me bashkësinë janë të detyrueshme¹ kur Këshilli:

- d) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. . .
- e) Miraton tjetërsimin ose dhëni në përdorim të pronave të tretëve.
- f) Vendos përtaksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- k) Miraton norma, standarde e kritere përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe përmbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Këshillimi me bashkësinë bëhet duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionet e interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore (neni 35/2).

3.1.1. KONSULTIMI ME PUBLIKUN PËR BUXHETIN DHE PAKETËN FISKALE (GERMAT “DH” & “F”)

Gjatë periudhës që mbuloi ky monitorim, Këshilli Bashkiak i Korçës ka kaluar dy buxhete, respektivisht atë të vitit 2011 dhe të vitit 2012. ZTQ ka raportuar se në asnjë prej rasteve, nuk u zhvilluan konsultime publike të thirrura nga Këshilli, në

respekt të detyrimit të tij ligjor.

Po ashtu, gjatë periudhës nën monitorim, Këshilli Bashkiak i Korçës ka bërë dy herë vendimarrje përtaksat e tarifat vendore, ose sikurse njihet ndryshe, Paketa Fiskale. Si vendimarrja e vitit 2011 (VKB nr. 13) ashtu edhe ajo e vitit 2012 (VKB nr. 2) nuk iu nënshtruan konsultimeve me aktorët e interesuar, të cilat duhet të organizoheshin nga vetë Këshilli (neni 35/1).

3.1.2. KONSULTIMI ME PUBLIKUN PËR TJETËRSIMIN OSE DHËNIEN NË PËRDORIM TË PRONAVE TË TRETËVE (GERMA “e”)

Si gjatë vitit 2011, ashtu edhe ne katërmujori e parë të vitit 2012, Këshilli Bashkiak i Korçës ka marrë rrëth 15 vendime përtjetërsimin ose dhëni en në përdorim të pronave të tretëve (shiko tab nr. 2, fq. 35, Aneksi 1). Nuk rezulton që Këshilli të ketë ndërmarrë paraprakisht konsultime me publikun, në kuptim që përcakton nenin 35/1, kur referon pikën nenin 32, germa “e”.

Siqështë bërë e qartë tashmë në parashtrimet më sipër, këto lloj vendimesh janë kaluar pothuajse me unanimitet në të gjitha rastet e vëzhguara. Kjo shtyn të mendosh që vendimarrja është dakortësuar paraprakisht, ndoshta gjatë procesit të hartit-

mit apo shqyrtimit të projek-vendimeve në komisionet e Këshillit Bashkiak.

Megjithatë, puna në këto komisione nuk ka qenë objekt i vëzhgimit nga afër prej ZTQ, Korçë, prandaj ajo nuk do të jetë pjesë e referimeve dhe vlerësimeve në kuadër të këtij Raporti. **Për këtë asrye, zbatueshmëria e pikës "e", neni 35/1 nuk do të përfshihet si një variabël i posaçem në grafikët mbi zbatueshmërinë e nenit përkatës (fq. 45).**

KONSULTIMI ME PUBLIKUN KU MIRATON STANDARTE DHE (GERMA "k")

Gjatë periudhës kohore që u monitorua, nuk u hasën vendimarrjeve për "**miratim të normave, standardeve e kritereve për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij (Këshillit) me ligj**", sipas kuptimit të germës "f" të nenit 32, gjatë periudhës nën monitorim. Rrjedhimisht, kjo kategori vendimesh nuk mund t'i nënshtrohet ndonjë vlerësimi të mundshëm.

KONSULTIMET E KRYETARIT TE BASHKISE

Kryetari i Bashkisë Korçë, Niko Peleshi ka qenë vazhdimi i përfshirë në nisma të ndryshme të cilat promovojnë buxhetimin me komunitetin. Këto nisma synojnë orientimin më të mirë të investimeve publike që realizon Bashkia në kuadër të buxheit vjetor që miraton Këshilli. Edhe pse janë plotësisht të lavdërueshme, këto procese konsultimi janë ekstra ligjore dhe legitimohen nga projekte donatorësh, por jo nga ligji 8652 per Pushtetin Vendor. Administrata e Bashkisë nuk ka funksione

*vendimarrëse, por ekzekutive. Është Këshilli ai që ka detyrimin ligjor të ndërmarrë konsultimet me komunitetin. Kjo është një kërkesë direkte e **ligjit 8652, të ndryshuar, e cila, për fat të keq, rezulton deri tanë se nuk është përbushur nga vendimarrësit vendorë të Korçës**. Konsultimet përbushen që ndërmerrin nga administrata e bashkisë, më saktë akoma nga kryetari saj, mbeten të konsiderohet një procedurë ekstra-ligjore. Sipas neni 36, germa "a", "Kryetari i bashkisë ushton të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës". Konsultimet publike përbushen dhe paketën fiskale për edhe ato për tjetësim pronë, apo për miratim normash dhe standartësh, janë kompetencë dhe detyrim ligjor ekskluziv i Këshillit, siç përcakton shprehimisht neni 35, pika 1, i cili referon direkt ne nenin 32, "Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak". Në rastin e konsultimit të buxheit me qytetarët, kryetari i Bashkisë ka ushtruar kompetencat e Këshillit Bashkiak. Projektet e shumta të ndërmarrja nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile të cilat venë në qendër të proceseve të konsultimit me bashkësinë kërët e bashkive dhe jo Këshillin Bashkiak, janë me legjimitet të diskutueshëm dhe nuk i shërbejnë promovimit të kulturës së respektimit të ligjit nga organet e qeverisjes ligjore (përkundrazi). Ky difekt i konceptimit të projekteve nga organizatat e shoqërisë civile duhet të dekurajohet nga komuniteti donator, sa kohë që ky i fundit, ka qëllim parësor nxitjen e respektit ndaj ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.*

Neni 36

KRYETARI I KOMUNËS OSE BASHKISË:

- a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
- b) zbaton aktet e këshillit;
- c) merr masa përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin komunal ose bashkiak, në përputhje me rendin e ditës të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- ç) raporton në kë shill për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;
- d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e komunës ose të bashkisë;
- dh) është anëtar i këshillit të qarkut;
- e) emëron dhe shkarkon zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e komunës ose të bashkisë;
- ë) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi.
- f) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë jodrejtues të strukturave dhe njësive në varësi të komunës ose bashkisë, përvèç kur parashikohet ndryshtësia ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësít civil";
- g) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar komunës ose bashkisë si person juridik;
- gi) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- h) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë.

GJETJET E MONITORIMIT



3.2 AFISHIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (neni 35/3)

AFISHIMI NË VENDE TË CAKUARA NGA KËSHILLI (STENDA PUBLIKE)

Në portën kryesore të godinës së Bashkisë Korçë, është e vendosur një stende tek e cila presupozohet të afishohen akte të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, gjykata e rrethit, etj. Sikurse u shpjegua edhe më sipër, kjo stende ka qenë objekt monitorimi të përditshëm nga ana e ZTO, Korçë²². Për të dokumentuar plotësisht rezultatet, kjo stendë u fotografua sistematikisht. Gjatë gjithë kohës që mbuloi ky monitorim, ka patur vetëm një rast afishimi të tre vendimeve në këtë stendë (Maj 2011).

NENI 35, PARAGRAFI 3

Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuar nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.



NJOFTIMI ME ANË TË FAQES ZYRTARE NË INTERNET

Një ndër mënyrat e mundshmë të njoftimit të vendimeve të Këshillit është edhe përmes faqes zyrtare në internet. Bashkia e Korçës ka një kategori të posaçme në faqen e saj për Këshilli Bashkiak, ku presuzozohet të publikohen vendimet e këtij të fundit. Hera e pare dhe njëkohësisht e fundit që është uploaduar një vendim i Këshillit Bashkiak në këtë kategori ka qenë në vitin 2009 dhe konkretisht vendimi **Nr. 9 Datë 11.02.2009**.

Në faqe ka edhe një kategori të posaçme për buxhetin e Bashkisë. Në këtë kategori janë të uploaduar tre buxhete, konkretisht ai i vitit 2008, 2009 dhe 2010. Po ashtu, në kategorinë: "**Bisnesi**", ka një nën-kategori për Paketën Fiskale. Këtu janë uploaduar paketat fiskale për vitet 2010, 2011, dhe 2012 (*koj e fundit është uploaduar si projekt vendim*).

Faqja ofron informacion të bollshëm lidhur me aktivitet e kryetarit të bashkisë, të shoqëruara me fotogaleri të larmishme. Po të gjykosh nga hapësira e pasqyrimit në faqen zyrtare të bashkisë Korçë të aktivitete të Këshillit, ky i fundit është thua se inekzistent. Ka shumë më tepër informacion përfestat e lakorit dhe të birrës sa për vendimet e Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Nisur nga këto rrethana, Qendra ÇIP ndërmori një proces rrënjesor dixhitalizimi të bazës së vendimeve të Këshillit Bashkiak. Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak, që nga viti 2007 e deri në Prill 2012 u dixhitalizuan nga ÇIP dhe u uploaduan në një databazë online, e cila më pas iu dhuruar në një ceremoni Këshillit Bashkiak Korçë (*shih më poshtë: Dhurimi i Databazës ose kliko: <http://www.infocip.org/al/?p=7060>*).

NJOFTIMI NË MEDIA

Sic u përmend më sipër, në Korçë zhvillojnë aktivitetin e tyre 3 televizione lokale. Përgjithësisht, çdo mbledhje e Këshillit Bashkiak ka gjetur pasqyrim të bollshëm në kronikat televizive në të treja televizionet.

Sa i takon njoftimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak, sipas kuptimit të nenit 35/3, nuk është konstatuar asnjë rast që media lokale të jetë përdorur nga Këshilli Bashkiak për të shpallur publikisht vendimet. Këto të fundit, ateherë kur kanë patur një interes për gazetarët, thjesht janë raportuar si pjesë e lajmit dhe në asnjë rast si njoftime.

Nuk rezulton që të ketë një praktikë të standartizuar, e cila të aplikohet konform një protokolli të caktuar nga Këshilli Bashkiak, Korçë në kuadër të një ndërveptimi të mundshmë me median lokale, në funksion të realizimit të njoftimit publik të vendimeve të Këshillit.

NJOFTIMI ME ANË TË BOTIMEVE PERIODIKE

Bashkia Korçë nxjerr një botim peridik të titulluar “*Qyteti im*”. Ky botim është në formatin e një reviste dhe mund të konsiderohet si një ndër botimet më të mira që nxjerrin organet e qeverisjes vendore në Shqipëri. Megjithatë, nga një hulumtim i kujdeshëm rezulton se Vendimet e Këshillit e Bashkiak nuk “kualifikohen” për të zënë një pjesë të hapësisës së këtij periodiku. Kjo në fakt do të ishte një muhdësi e shkëlgjer për të realizuar në mënyrë efikase njoftimin e akteve të Këshillit, të cilat janë në themel të qeverisjes së qytetit.

ZYRA E INFORMACIONIT NË BASHKI

Bashkia Korçë ka një zyrë bashkëkohore informacioni, me një staf të dedikuar, i cili krijon

marrdhënie të mira me publikun. Në thelb, zyra e informacionit implikon materializimin në paraktikë të së drejtës së qytetarëve për të kërkuar informacion nga administrata publike, në zbatim të së drejtës së tyre kushtetuese dhe ligjore. Baza ligjore për ngritjen dhe funksionimin e saj, përvèç ligjit 8503, është edhe fjalia e dytë e paragrafit 3 të nenit 35. Ky nen përcaktont shprehimisht se: “*Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli caktion edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përpunhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe rregullat e përcaktuara nga vejet këshilli përkatës për këtë qëllim*”. Objekt vlerësimi në këtë raport është vetëm fjalia e parë, e cila cakton detyrimin për afishimin / publikimin e vendimeve të Këshillit, ose e thënë ndryshe informimin proaktiv (eng: *proactive disclosure*). Fjalia e dytë, e cila implikon informimin aktiv (aktivizohet nga qytetarët) nuk është objekt vlerësimi, pasi ajo referon drejtpërdrejt një ligj tjeter. Bazuar mbi këtë diferencim, edhe performanca e zyrës për informimin e publikut, e ngritur në Bashkinë Korçë, nuk është objekt vlerësimi në kuadër të raportit. Për më tepër, sa kohë që kjo zyre është brenda godinës së bashkisë, nuk do të mund të konsiderohej dot as “vend publik”, sipas kuptimit që mbart dispozita në paragrafin 3, Neni 35 (*shih: Matrica e Matjes dhe e Vlerësimit, Pjesa III*).

Edhe nga vëzhgimet e ZTQ, Korçë, nuk rezulton që vendimet e këshillit të jenë administruar apo shpërndarë nga kjo njësi informimi, por nga sekretari i Këshillit Bashkiak. Vetë ZTQ dhe Qendra ÇIP iu drejtuani këtij të fundit për të disponuar bazën e plotë të vendimeve për t'i u dixhitalizuan dhe hedhur në databazën online.

NENI 37 SEKRETARI I KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli komunal ose bashkiak, mbi bazën e propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak është përgjegjës për:
 - a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
 - b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës;
 - c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
 - d) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga këshilli komunal ose bashkiak;
 - d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
3. Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

ANEKS NR.1

Tab 1 - Vendime individuale nominale gjate konstituimit

Nr	Atributet e aktit	Hyrja ne fuqi	Lloji i aktit	Menyra e votimit
1.	Vendim nr. 28, dt. 29.06.2011 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehte
2.	Vendim nr. 29, dt. 29.06.2011 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehte
3.	Vendim nr. 30, dt. 29.06.2011 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehte
4.	Vendim nr. 40, dt. 28.07.2011 "Per ndryshimin e numrit te anetareve te Keshillit mbikqyres te T.SH.SH.F.P Korce SH.A"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehte
5.	Vendim nr. 41, dt. 28.07.2011 "Per shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rindjeve te Keshillit mbikqyres te T.SH.SH.F.P Korce SH.A"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehte
6.	Vendim nr. 42, dt. 28.07.2011 "Per shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rindjeve te Keshillit mbikqyres te "Ujeselles Kanalizime" Korce SH.A"	Mbas 10 ditesh	IND	E fshehtë
7.	Vendim nr. 50, dt. 05.10.2011 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore"	Menjehere	IND	E fshehte

Tab 2 - Vendime per tjetërsim prone ose dhënie në perdomim te tretëve

1.	Vendim nr. 2, dt. 14.01.2011 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve te inventarit ekonomik dhe atij te imet"
2.	Vendim nr. 53, dt. 05.10.2011 "Per blerjen e truallit prej 97 m ² te ndodhur ne lagjen 12 te qytetit te Korces dhe autorizimin e kryetarit te Bashkise per nenshkrimin e kontrates se shitblerjes"
3.	Vendim nr. 79, dt. 03.11.2011 "Per kalim ne privatizim te banesave shteterore"
4.	Vendim nr. 84, dt. 25.11.2011 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve te inventarit ekonomik dhe atij te imet dhe per kalim inventari"
5.	Vendim nr. 89 dt. 15.12.2011 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve te inventarit ekonomik dhe atij te imet dhe per kalim inventari"
6.	Vendim nr. 91 dt. 27.12.2011 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve te inventarit ekonomik dhe atij te imet"
7.	Vendim nr. 95 dt. 27.12.2011 "Per fillimin e procedurave te privatizimit te ish-kapanoneve te ish- Ndermarrjes se Parkut te Transportit, prone ne inventar te Bashkise Korce "
8.	Vendim nr. 97 dt. 27.12.2011 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve te instalimeve teknike te makinerive dhe pajisjeve per vegla pune dhe objekte inventari"
9.	Vendim nr. 3, dt. 13.02.2012 "Per fillimin e procedurave per dhenien me qira te truallit me siperafe prej 205 te ndodhur ne Lgj. 14, Rr. "Partizani"
10.	Vendim nr. 4, dt. 13.02.2012 "Nxjerrjen jashte perdomit te materialeve tit installme teknike makineri pajisje vegla pune dhe objekte inventari"
11.	Vendim nr. 7, dt. 13.02.2012 "Nxjerrjen jashte perdomittit materialeve tit inventarit te imet "
12.	Vendim nr. 9, dt. 13.02.2012 "Vendim Per kalim ne privatizim te banesave shteterore
13.	Vendim nr. 25, dt. 26.03.2012 "Per kalimin ne privatizim te banesave shteterore "
14.	Vendim nr. 36, dt. 18.04.2012 "Per kalim ne privatizim te banesave shteterore "
15.	Vendim nr. 39, dt. 18.04.2012 "Per kalim ne privatizim te banesave shteterore "



REAGIMI I QENDRËS ÇIP DHE ZTQ KORÇË PËR KONSTULTIMIN

Administrata e Bashkisë Korçë përfundoi hartimin e projekt-Paketës Fiskale 2012 në fillim të Shkurtit 2012. Nisur nga praktika joligjore e vitit 2011, në datë 8 Shkurt, 2012, Qendra ÇIP dhe dega e saj në Korçë, Zyra e Transparencës Qytetare, organizuan një takim të madh publik për t'i kërkuar publikisht Këshillit Bashkiak zhvillimin e konsultimeve publike para se projekt-vendimi të kalonte për miratim në seancë plenare. Në deklaratë theksohej qartë se "Paketa Fiskale është akti më i rëndësishëm normativ që Këshilli Bashkiak miraton në një vit krahës buxhetit. Paketa cakton barrën fiskalë që çdo qytetar duhet të derdhë në arkën e bashkisë në formën e taksave dhe tarifave. Si e tillë, diskutimi me vetë taksapaguesit është një proces që duhet marrë shumë seriozisht. Kjo vendimarrje prek këdo që jeton e punon në territorin që administrohet nga Bashkia Korçë, qofshin këto bisnese të mëdha, të vogla apo qytetarë të thjeshtë".

Qendra ÇIP i ofroi publikisht Këshillit Bashkiak ndihmësën e vet për të realizuar në një kohë shumë të shpejtë një forum diskutimi publik sipas modelit të konsoliduar me Këshillin Bashkiak në Durrës. Kërkesa bazohej në nenin 35, pika 2, e cila përcakton shprehimisht se Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore".

Pavarësisht këtij apeli për të mos anashkaluar detyrimin ligjor për vendimarrje të konsultuar, Këshilli Bashkiak, Korçë e futi projekt-vendimin ne seancë plenare një javë më pas, ashtu sikurse ishte hartuar nga administrata e bashkisë, duke e miratuar pothuajse pa ndryshime.





E PAKETËS FISKALE 2012 ME AKTORËT E INTERESIT

Rreth 10 ditë më pas, Prefekti e kthen përrishqyrtim në Këshill Bashkiak vendimin e Paketës Fiskale 2012, me arsyetimin se nuk ishin respektuar hallkat ligjore përkonsultimin e projekt-vendimit me palët e interesuara.

Këshilli Bashkiak e rifuti në axhendë e mbledhjes së datës 26 Mars 2012 rishqyrtimin e Vendim nr. 2, dt. 13.02.2012 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre në qytetin e korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative", dhe sërisht e kaloi atë pa ndryshimet e kërkua nga Prefekti. Në këtë rast, ndryshimet kishin të bënin me procedurën e vendimarrjes, pra me zhvillimin e konsultimeve me publikun, dhe jo me përbajtjen e aktit.

Sipas përcaktimeve ligore, prefekti ka të drejtë vetëm një herë të ktheje përrishqyrtim aktin, nëse konstaton që ai nuk është hartuar apo miratuar në përpjegje me ligjin.

Prefekti ka të drejtë të padisë në gjykatë

Këshillin në rast të mos respektimit të kërkesave të tij pas rikthimit përrishqyrtim të aktit. Edhe pse Këshilli nuk e mori parasysh kërkesën edhe herën e dyte, prefekti nuk veproi me tej përrëtë atakuar tashmë në gjykatë shkeljen e kërkesave të ligjit në rastin e këtij vendimi.

Qytetarët korçarë filluan të ankoreshin të masë se administrata e bashkisë kishte filluar vjeljen e tarifave të reja përrash ujin pa u miratuar më parë Paketa Fiskale 2012 nga Këshilli Bashkiak. Këto ankesa u bënë mëse njëherë publike edhe përmes medias kombëtare, dhe më shumë akoma në median lokale. Tarifat e rritura përrash ujin, që u mblohdën nga administrata e bashkisë përrash Janarin dhe Shkurtin, ishin sa ato që parashikoheshin në draftin e Paketës Fiskale 2012, e cila edhe pse u kalua fillimisht në Shkurt (VKB nr. 2), hyri në fuqi vetëm në muajin Prill, pasi Këshilli e rivotoi atë, pas kthimit përrishqyrtim nga prefekti.





RRITET TRANSPARENCA VENDORE

ÇIP I DHURON BASHKISË KORÇË DATABAZËN ONLINE TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK, '07-'12

Korçë, 28 Mars, 2012 – Bashkia e Korçës ka tashmë një standart të ri transparencë në vendmarrje. Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak që nga viti 2007 e deri sot gjenden online, të linkuara në faqen e saj zyrtare <http://www.bashkiakorce.gov.al>

Kjo databazë dixhitale shumë e rëndësishme u ndërtua nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP, përmes koordinimit me degën e saj lokale, Zyra për Transparency Qytetare, Korçë dhe falë mbështetjes së Fondacionit Soros.

"Qendra ÇIP dha dega e saj ne Korce, Zyra për Transparency Qytetare, i bejne një sherbim te vyer sot transparencës se Këshillit Bashkiak. Ata sot i dhorojnë jo vetem Bashkise, por

mbi te gjitha qytetareve korçare arkiven e dixhitalizuar te vendimeve te Këshillit Bashkiak. Ky eshte vertet një kontribut special, me vlerë te padikutueshme dhe qe mbush mirefilli një vakum qe ishte akumuluar ne keto vjet sa i takon aksesit efektiv ne vendimet e Këshillit si dhe perdorimit praktik te teknologjive te reja te informacionit qe i vijne direkt ne ndihme qytetarit", u shpreh në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i Këshillit Bashkiak, Z Ilirian Pendavinji.

Ndërsa Kryetari i Bashkisë, Z Niko Peleshi, i cili ishte gjithashtu i pranishëm në ceremoninë e dhurimit të databazës iu shpreh se "Sa më shume që thollohet procesi i decentralizimit, aq me shume vendimet e Këshillit Bashkiak dhe politikat e Bashkisë kane ndikim mbi cilesine



Databaza e Akteve te Pushteti Lokal, Korçë ofron mundësi për të gjithë qytetarët që të njihen me vendimet e Këshillit Bashkiak në çdo kohë, pa pagëz qe nre mënyrë efikase. Mjalon një klikim mbi titullin e vendimit dhe Databaza do të hapë menjëherë përbërjet e tij në PDF.

Çip vendimi i Këshillit Bashkiak, Korçë që nga viti 2007 e deri më sot, është dixhitalizuar nga Qendra ÇIP përmes koordinimit me degën e saj në Korçë, Zyra e Transparency Qytetare. Motoja e kësaj Zyra është: "Oftëzat korçare duhet ta dëjë çfarë vendimesh morren në emër & tyre".


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 12 Datë 08.03.2012

MBI MIRATIMIN E REALIZIMIT TE BUXHETIT TË BASHKISË DHE
INSTITUCIONEVE TË VARTËSISÉ PËR VITIN 2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mësori në shqyrim reportin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «Mbi



e jetes se çdo qytetari. Këto vendime duhet të jenë të aksesueshme efektivisht nga cilido qytetar, në cdo kohë. Ne jemi të vetëdijshmë për problemtë që kemi patur në këtë drejtim deri më sot".

"Sot, ne Republiken e Shqiperise ka vetëm dy bashki te cilat disponojne një database online te vendimesh të Keshillit Bashkiak, konkretisht Durresi dhe Korca. Ne ketyt dy të fundit, kjo database eshte krijuar dhe me pas dhuruar nga Qendra ÇIP dhe Zyrat e saj të Transparencës Qytetare. "Ne jemi shume te kenaqur per kete arritje", u shreh drejtori ekzekutiv i Qendrës ÇIP, Gerti Shella. Ai falenderoi në mënyrë të veçantë anëtarët e Zyrës për Transparencyë Qytetare Korcë, të cilët kanë ditur të reflektojnë në praktikë të gjithë trajnimin dhe udhëzimet e marrë për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimarrëse, por edhe për të ritur aksesin efektiv në aktet e bashkisë.

Perdorimi i teknologjive te reja dhe hapja udaj inovacionit eshte nje uder 12 Parimet e Qeverisjes se Mire dhe Demokratike te Keshillit te Evropes, per zbatimin e te cilave Bashkiak Korce ka marre angazhim pernes uenshkrimit nga ana e kryetarit te saj, Z Niko Peleshi, te kontrates sociale me qytetaret ne prillin e vitin te kaluar. Sot, edhe falë ndihmesen konkrete te Zyres per Transparency Qytetare dhe te Qendres ÇIP, ky angazhim kontraktual mund te konsiderohet i permbushur.

Po ashtu, mosqjetjen e vendimeve qe nxirrën nga pushteti lokal e konstaton si një problem të mprehtë edhe "Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike" që është dokumenti kryesor i qeverisë shqiptare në këtë drejtim. Kjo Strategji e adreson per zgjidhje brenda vitit 2013 kete problem, por deri me tani eshte bere shume pak ne kete drejtim nga administrata lokale.

Databaza e Akeve të Pushteti Lokal, Korçë ofron mundësi për të gjithë qytetarët që të njihen me vendimet e Këshillit Bashkiak në çdo kohë, pa pagëzue dhe në mënyrë efikase. Mjafton një klikim mbi titullin e vendimit dhe **Databaza** do t'ë hapjen menjerë përbajtjen e tij ne PDF.

Çdo vendim i Këshillit Bashkiak, Korçë që nga viti 2007 e deri më sot, është dixhitonalizuar nga Qendra CIP përmes koordinimit me degën e saj në Korçë, Zyrat e Transparency Qytetare. Motoja e kësaj Zyre është: ***"Qytetarët korçarë duhet ta dijnë çfarë vendimesh merrën në emër të tyre"***.

Kjo Databazë që Qendra ÇIP i dhuron Bashkisë Korçë dhe përmes saj gjithë subjekteve që ajo administron, është mundur falë ndihmës së ofruar nga Fondacioni Shqiptar për Shqipërinë e Hapur, SOROS.

 Bashkia Korce

- Viti 2012
 - Viti 2011
 - Viti 2010
 - Viti 2009
 - Viti 2008
 - Viti 2007

VIDEO-ARKIVA E MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK, KORÇË

Për të adresuar efektivisht për zgjidhje problemin e ndjekjes së mbledhjeve, ÇIP ndërmori një proces relativisht të komplikuar për ndërtimin e një videoarkive online, në të cilën të aplodoheshin të gjithë mbledhjet e Këshillit, për t'i dhënë në këtë mënyrë gjithsecilit mundësi për të ndjekur procesin vendimarrës. Ajo është një materilizim konkret i aplikimit të teknologjive të reja të informacionit në promovimin e transparencës vendimarrëse në nivel vendor.

Qytetarët e Korçës patën mundësi që të ndjekin e mbledhjet e Këshillit Bashkiak edhe online gjatë kohës së këtij projekti, përmes faqes së Qendrës ÇIP, www.infocip.org,

The screenshot shows the ÇIP website's video archive section. It features a header with the ÇIP logo, a map of Albania, and a banner for 'Access Open and transparent decision making'. Below the header are navigation links: Databaza Elektronike e Akteve, HOME, RRETH NESH, KU PUNOJME, AKTIVITETE, PUBLIKIME, FORUM, and KONTAKT. A search bar is also present. The main content area is titled 'KESHILLI BASHKIAK KORÇË' and displays a video thumbnail for 'Video-arkiva e mbledhjeve te Këshillit Bashkiak, Korçë (Janar '11-Prill '12)'. Below the title are four smaller video thumbnails with captions: 'Mbledhja e dates 14 Janar 2011', 'Mbledhja e dates 14 Janar 2011, pjesa e dyte', 'Mbledhja e dates 17 Shkurt 2011', and 'Mbledhja e dates 9 Mars 2011'. To the right, there are sections for 'DEGET LOKALE TË ÇIP', 'Zyra e Transparencës Oftare, Durrës (19)', 'Zyra e Transparencës Oftare, Korçë (21)', and a sidebar with links to 'VENDIMARIA NË KËSHILLIN BASHKIAK DURRËS DHE PROGRAMI I KONSULTIMEVE ME PUBLIKUN shikoji online në audio-video' and 'ÇMIME TE DHENA NGÀ ÇIP'.

The screenshot shows the ÇIP website's homepage. It features the ÇIP logo, a map of Albania, and a banner for 'Enhancing governmental transparency'. Below the banner is a large video thumbnail showing three men in suits sitting at a conference table during a meeting. Navigation links include: HOME, RRETH NESH, KU PUNOJME, AKTIVITETE, PUBLIKIME, FORUM, and KONTAKT. A search bar is also present. To the right, there are sections for 'DEGET LOKALE TË ÇIP', 'Zyra e Transparencës Oftare, Durrës (19)', 'Zyra e Transparencës Oftare, Korçë (21)', and a sidebar with links to 'VENDIMARIA NË KËSHILLIN BASHKIAK DURRËS DHE PROGRAMI I KONSULTIMEVE ME PUBLIKUN shikoji online në audio-video'.

Dt. 5.10.2011, Pjesa e pare from Qendra ÇIP on Vimeo.

në vendimarrje përmes teknologjive të reja të informacionit.

Dokumentim rigoroz në audio-video i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Korçë ishte shumë i rëndësishëm edhe për vlerësimin prej cilitdo të të modaliteteve ligjore të vendimarrjes në nivel vendor. Kjo video-arkive përfaqëson një vlerë të shtuar të projektit që ÇIP implementoi në Korçë. Videoarkiva përmban të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, qe nga muaji Shkurt 2010 e deri ne Prill 2012. Për më shumë shiko:

http://www.infocip.org/al/?page_id=271

e linkuar tashmë në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli i ri Bashkiak si ai pararendes, ashtu edhe ai që doli pas zgjedhjeve të Majit 2011, janë filmuar nga Qendra ÇIP dhe më pas janë uploaduar online në një video-arkivë moderne. Kjo qasje krejt unike i jep një dimension të ri transparence veprimtarisë vendimarrëse të Këshillit Bashkiak, Korçë, duke e bërë atë kështu bashkë me Durrësin, të vetmet bashki në Republikën e Shqipërisë, që disponojnë video-arkive online të aktivitetave vendimarrëse. Kjo video-arkive e bën Këshillin Bashkiak Korçë një lider në rajon sa i takon promovimit të transparencës

The screenshot shows the ÇIP website's homepage again. It features the ÇIP logo, a map of Albania, and a banner for 'Open and transparent decision making'. Below the banner is a large video thumbnail showing a group of people in a meeting room. Navigation links include: Databaza Elektronike e Akteve, HOME, RRETH NESH, KU PUNOJME, AKTIVITETE, PUBLIKIME, FORUM, and KONTAKT. A search bar is also present. To the right, there are sections for 'DEGET LOKALE TË ÇIP', 'Zyra e Transparencës Oftare, Durrës (19)', 'Zyra e Transparencës Oftare, Korçë (21)', and a sidebar with links to 'VENDIMARIA NË KËSHILLIN BASHKIAK DURRËS DHE PROGRAMI I KONSULTIMEVE ME PUBLIKUN shikoji online në audio-video'.

ÇIP DHE ZTQ, KORÇË DISKUTOJNE GJETJET PËRFUNDIMTARE TË MONITORIMIT

Korçë, 19 Mars 2012 – Stafi i Qendrës ÇIP dhe anëtarët e Zyrës së Transprencës Qytetare, Korçë u takuan në dt 19 Mars në Korçë për të diskutuar mbi gjetjet përfundimtare të monitorimit 15 mijor të aktivitetit të Këshillit Bashkiak Korçë. Takimi synonte përvthihjen e drejvërdrejtë të mendimit të të gjithë anëtarave të ZTQ, Korçë para organizimit final të gjetjeve në Raportin që do të hartohej nga Qendra ÇIP (shikoje ne video: <http://www.infocip.org/al/?p=7676>).

Në këtë takim të fundit u hapën edhe njehere përvlerësim të gjitha gjetjet e mbledhura dhe të referuar nga ZTQ, Korçë. Të gjithë anëtarët patën mundësi të theksojnë ato momente të cilat për ta kanë rëndësi të evidentohen qartë në raportin që do të hartohej nga ÇIP. Objekt matjeje dhe vlerësimi në Raport janë pjesëmarrja në vendimarrje e aktorëve të interesit dhe respektimi i modaliteteve ligjore për diskutimin paraprak, votimin dhe shpalljen e vendimeve të Këshillit.

Ky takim i zhvilluar në Korçë, ishte pjesë e ndërveprimit të synuar mes dy strukturave, respektivisht në bazë dhe në qendër, i parashikuar edhe në metodologjinë e projektit të zhvilluar nga ÇIP. Mjeti kryesor metodologjik që u zhvilluar prej kësaj të fundit për realizimin e këtij projekti u emërtuar PRO AKTIV (akronim i modifikuar për: "Protokoll i Vlerësimit te Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive". Në përgjithësi kjo Metodologji implikon ndërveprimin midis një strukture "grassroots" (ZTQ) dhe një organizate think tank (ÇIP).

E para, në ndërveprimin e saj me strukturat në nivel lokal gjeneron të dhëna në terren të cilat i përcillën strukturës së specializuar në qendër përpunim, amplifikim, dhe gjenerim konkuzionesh. Substanca e kësaj analize është matja dhe vlerësimi i nivelit të zbatueshmrisë së ligjit nga strukturat lokale, objekt monitorimi (në rastin konkret Këshilli Bashkiak, Korçë). Nga ana tjetër, struktura "grassroots" ushqehet nga struktura Think Tank me një protokoll të detajuar mbi bazën e të cilit ndërtohet ndërveprimi me Këshillin Bashkiak.

Është me rëndësi të theksohet se kjo metodologji bazohet mbi prezumimin se kuadri ligjor i cili normon procesin vendimarrës në nivel lokal dhe transparencën që duhet të bashkëshoqëroja atë, është i kompletuar dhe garantues. Në fakt kjo përkon me vlerësimin e përhapur se vende si Shqipëria kanë (adoptuar) legislacion të mirë, dhe se problemet e hasura burojnë nga implementimi i pamjaftueshëm (i keq) i këtij legislacioni.



PJESA E TRETË

**MATJA E ZBATUESHMËRISË
SË NENEVE 33, 34, 35
DHE PËRLLOGARITJA
E NIVELIT TË TRANSPARENCEΣ**

3

MATJA E ZBATUESHMËRISË SË NENEVE 33,34 DHE 35 DHE PËRLLOGARITJA E NIVELIT TË TRANSPARENÇËS

Në kuadër të këtij Raporti, ÇIP ka përllogaritur nivelin e zbatueshmërisë së neneve 33, 34 dhe 35 të ligjit organik 8652 "Për Organizimin e Funksionimin e Qeverisjes Vendore", *ndryshuar* të cilat janë kusht jurik për realizimin e një procesi vendimarrës të hapur dhe me pjesëmarrje, duke garantuar njëkohësisht akses të publikut në mbledhjet dhe vendimet e Këshillit (*shih: Pjesa e Parë*).

Kjo përllogaritje ishtë ndër objektivat kryesore të projektit. Mesatarja e zbatueshmërisë (implementimit) së dy neve të fundit, 34 (*Mbledhjet e hapura*) dhe 35 (*Seancat e këshillimeve me bashkësinë e drejta e publikut për t'u informuar*), indikojnë automatikisht dhe drejtëpërdrejt *nivelin e transparencës në procesin vendimarrës të realizuar nga Këshilli Bashkiak*. Kjo matje dhe ky vlerësim realizohen për herë të parë në Shqipëri. Ajo indikon njëkohësisht respektimin e normave ligjore në fuqi nga vendimarrësit e qyteteve (ligjshmërinë e vendimarjes). Metoda matëse u zhvillua nga ÇIP dhe u përdor për herë të parë në Korçë dhe Durrës. Ajo përfaqëson një risi, një sintezë të eksperimentës së ÇIP në drejtim të matjes, vlerësimit dhe promovimit të informimit proaktiv¹ nga institucionet vendimarese, tashmë në nivel vendor.

Jasi funksion ajo: Secili nga nenen e marrë nën vlerësim përmban paragrafë (pika ose germa), që në disa raste janë të përbërë prej më shumë se një fjali. Secili fjali mund të përbajë një apo disa dispozita (ose në ndonjë rast tjetër asnjë). Metoda e zhvilluar nga ÇIP për vlerësimin e zbatueshmërisë së neneve objekt monitorimi parashikon filimi identifikimin e çdo dispozite që përmban secila fjali brenda paragrafëve të një nenit të dhënë (*shih në faqen tjetër: Matrica e Matjes dhe Vlerësimit*). Pasi matet dhe vlerësohet zbatueshmëria në praktikë e secilës dispozitë, mesatarja e vlerave të tyre çon në vlerësimin e zbatueshmërisë së çdo fjalë (atyre që kanë dispozita) brenda paragrafit të një nenit. Pasi matet edhe zbatueshmërie e secilit paragraf, vlerësohet zbatueshmëria e të gjithë nenit, që në këtë rast është mesatarja e zbatueshmërisë së çdo parografi të tij.

Le ta konkretizojmë këtë metodë vlerësimi duke marrë si shembull ninen 35 *të ligjit 8562, të ndryshuar*. Ky nen përmban 4 paragrafë (pikat 1, 2, 2/2 dhe 3) të cilat më poshtë do të referohen thjesht si pika. Pika 1 përcakton se: "Këshilli komunal ose bashkiak, përpëra shqyrimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seancë këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji."

Pika 1 ka dy fjali. E para cakton një rregull të përgjithshëm, ndryshe nga fjalia e dytë që vendos një detyrim konkret (dispozitë) ndaj këshillit për të zhvilluar diskutime me publikun për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji" (respektivisht

diskutimi publik i projekt-buxhetit (dh), të tjeterësimi i proçave (e), miratimi i Taksave & Tarifave (f) si dhe kur këshilli miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që ka me ligj (k)). Secila nga këto germa është një dispozitë konkrete. Në rastin konkret, nga monitorimi rezulton se "dh" dhe "f" nuk janë respektuar, pasi as Buxheti dhe as Paketa Fiskale nuk i janë nënshtruar konsultimit të iniciuar nga Këshilli me aktorët e interesit. Sa i takon zbarueshmërisë së germës "e", të prezumohet që komisionet e këshillit janë konsultuar paraprakisht, çka mbështetet edhe nga votimi thuajse unanim i këtyre vendimeve. Por, sa kohë qe aktiviteti i komisioneve nuk ka qenë objekt monitorimi, për kujdes metodologjik, kjo pikë nuk do të përllogatit si variabël më vete në zbatueshmërinë e pikës 1 të nenit 35. Kurse, sa i takon germës "k", nuk rezulton që ajo të jetë aktivizuar ndonjëherë (Këshilli nuk ka patur rast konkret për të bërë një vendimarrje të tillë). Pra edhe germa "k", nuk do të jetë një variabël në përllogaritjen e pikës 1 të nenit 35.

Zbatueshmëria e paragrafit (pikës 1 të nenit 35) është këtë rast e barabartë me mesataren e zbatueshmërisë së dispozitave "dh" dhe "f" për periudhën nën monitorim.

Më pas, në këtë mënyrë vlerësohet zbatueshmëria e pikës 2 të nenit 35, e mandej edhe pika 3. Pika 2/1 nuk është objekt vlerësimi pasi ajo del jashtë mbulimit gjeografik të projektit. Vlera mesatare e zbatueshmërisë së pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 35 prodhon vlerën e zbatueshmërisë së nenit 35 në tërësi.

Mesatarja e vlerave të zbatueshmërisë së neneve 34 dhe 35 indikon nivelin e transparencës vendimarrëse të Këshillit Bashkiak Korçë, sa kohë që këto dy nene përcaktojnë modalitete për një vendimarrje të hapur dhe me pjesëmarrje, si dhe aksesin e publikut në vendimet e Këshillit.

Zbatueshmëria e nenit 33 paraqet një interes më të ulët në kuadër të këtij monitorimi për shkak të faktit se ai "targeton" vetëm Këshillin dhe jo publikun dhe/apo përfshirjen e tij në vendimarrje, çka është qëllim kryesor i kësaj nisme. Skurse është bërë e qartë, vendimarrja me pjesëmarrje garantonet përmes zbatimit rigoroz të neneve 34 dhe 35 të ligjit në fjalë. Megjithatë, të monitorosh procesin vendimarrës në nivel vendor, duke anashkaluar me qëllim vlerësimin e modaliteteve të votimit të akteve nga Këshilli gjatë mbledhjeve të tij, do të ishte që në pikënisje një nismë e cunguar. Duhet ritheksuar këtu se përmirësimi i praktikës së votimit në këshillin bashkiak nuk ka qenë ndër objektivat e projektit. Mesatarja e zbatueshmërisë së nenit 33 duhet konsideruar si një e dhënë e cila meriton të adresohet direkt nga vetë Këshilli dhe jo, fjala vjen, nga operatorë të shoqërisë civile.

Matrica e Matjes & Vlerësimeve

Neni	Paragrafi	Teksti në paragraf	Objekt matje dhe vlerësimi brenda paragrafit	Dispozitat	Perqindja ne vlerësimin e zbatueshmërisë se nenit	Subjekt analize krahasuese
33	1	Votimi në këshill bëhet i hapur os e i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë.	Fjalia e dyte		20%	JO
	2	Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.	Parografi i pote		20%	JO
	3	Vendimet, për rastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "F", "g", "gi", "i" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.	Parografi i pote		20%	JO
	4	Vendimet merren me tre të pestat të numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji.	Parografi i pote		20%	JO
	5	Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.	nuk aplikohet		N/A	JO
	6	Aktet e këshillit shpalen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofitimit të tyre subjekteve.	Fjalia e pare	a- Shpallja në akt 50% b- Koha e hyrjes ne fuqi 50%	20%	JO
34	1	Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo çytetar lejohet të njojekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.	Parografi i pote		50%	PO
	2	Njofitimi përmblidjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njofitimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.media.	Parografi i pote	a- Vend 25% b- Media 25% c- Website 25% d- Telephone.Email 25%	50%	PO
	3	Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm te anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e myllur.	nuk aplikohet		N/A	PO
35	1	Këshilli komunal ose bashkiak, përparrë shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "F" dhe "k" të këtij ligji.	Fjalia e dyte	"dh" Buxheti 50 "e" Nuk aplikohet "F" Paketa Fiskale 50 "k" Nuk aplikohet	33%	PO
	2	Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshe si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionë të interesuara dhe organizata joqeveritarë ose nëpërmjet organizimit te referendumeve vendore.	Parografi i pote		33%	PO
	2.1	Për këshillat komunale/bashkiake janë te detrueshme seancat e këshillimit me kryetaret dhe kryesine e fshatrave nen juri diksion, ne përputhje me përcaktimet e bëra ne shkronjat "ç", "dh", "e", "F", "k" dhe "ll" te nenit 32 te ligjit. Seancat shënohen ne procesverbali.	nuk aplikohet		N/A	PO
	3	Aktet e këshillit afroshohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe formë të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli	Fjalia e Parë		33%	PO

MBI IDENTIFIKIMIN E DISPOZITAVE NË PARARAFE DHE NENE DHE MATJEN E ZBATUESHMËRISË SË TYRE

Matrica e Matjes & Vlerësimit është mekanizmi bazë që "filtron" të gjitha dispozitat e matshme të neneve 33, 34 dhe 35.

Pasi i identifikon dhe i veçon dispozitata, ajo ponderon secilën prej tyre me përqindje në vlerësimin përfundimtar të nenit përkatës.

Matrica, përashton nga vlerësimi ato paragrafe, apo dispozita që nuk mund të janë objekt vlerësimi përsye që lidhem kryesisht me mos-hasjen e tyre në praktikën vendimarrëse të Këshillit (shënuar me të kuqe).


Konkretnisht, nëse një nen ka 6 paragrafe (psh. nen 33), atëherë secili prej tyre ka 16.6 pikë përqindje në vlerësimin e zbatueshmërisë së tij ($16.6\% \times 6 = 100\%$). Nëse ndonjë nga këta paragrafë nuk është referuar në praktikën vendimarrëse të Këshillit, pasi situata parashikuar prej paragrafit në fjalë nuk është hasur gjatë periudhës nën monitorim, atëherë,

ky paragraf nuk përfshihet (ekskludohet) në prosesin e vlerësimit të zbatueshmërisë së nenit. Pesha specifike e tij në vlerësim shpërndahet tek paragrafet e tjerë të nenit. Konkretnisht, në nenin 33, paragrafi (pika) 5, i cili parashikon rivotimin për kryetari, zv. kryetarin dhe sekretarin e këshillit kur nuk arrihet shumica e kërkuar, nuk hyri asnjëherë në veprim gjatë periudhës nën monitorim. Këshilli i ri Bashkiak i cili doli pas zgjedhjeve të 8 Majit 2011, zgjodhi drejtuesit e vet që në raundim e parë të votimit. Prandaj, paragrafi 5 i nenit 33 nuk përllogaritet në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit. Pika e tij shpërndahen tashmë në 5 paragrafet e tjerë, duke bërë që këta të fundit tashmë të kenë secili një peshë specifike në vlerësim prej 20 pikë përqindje ($100\% / 5 = 20\%$).


Në grafikët në vijim, mund të hasni shkurttime të fjalës **Paragraf (shkurt: P)** dhe **Neni (shkurt: N)**.

1. MATJA DHE VLERËSIMI I ZBATUESHMËRISË SË NENIT 33 "VOTIMI"


Zbatueshmëria e **votimit të fshehtë**, fjalia II, P. 1, N. 33




Vendosja në akt e dt. shpalljes, dispozita a, fjalia I, P. 6, N. 33



Zbatueshmëria e **Dispozitave: a & b**, P. 6, N. 33




Zbatueshmëria e **të gjithë paragrafëve** të NENIT 33




MBI VIZUALIZIMIN E TË DHENAVE PËR ZBATUESHMERINË E NENIT 33 "VOTIMI"

Grafiku 1 paraqet reportin midis rasteve kur Këshilli ka realizuar **votim të fshehtë** vs. **votim të hapur** për vendime me karakter individual. Sipas paragrafit 4 fjalia e dyte, të nenit 33, "Aktet me karakter individual nuk do të kundrohet me votim të fshehtë (sili shpjegohen narrative tek fjt. 24-22). Grafiku 2 paraqet Mesatarja e Zbatueshmërisë së paragrafit 1, nen 33. Grafiku 3 paraqet zbatueshmërinë e dispozitave të paragrafit 6. Keto dispozita janë a) **përcaktimi formal i kohës** së shpalljes, në trupin e aktit, b) caktimi i kohës së hyrjes në fuqi. Secila nga këto dy dispozi-


Mesatarja e Zbatueshmërisë së **Paragrafit 1**, N.33




Përcaktimi i hyrjes në fuqi, dispozita b, fjalia I, P. 6, N. 33



Mesatarja e Zbatueshmërisë së **Paragrafit 6**, N.33




Zbatueshmëria vs. **Mos-zbatueshmëria** e NENIT 33



ta kanë nga 50% të pikëve në vlerësimin e zbatueshmërisë së fjalisë II të paragrafit 6, nen 33. Paragrafet 2, 3 dhe 4 të nenit 33 rezultojnë me zbatueshmëri 100%. Për ekonomi hapërsire në faqe, grafikët respektive të këtyre paragrafave (2, 3 dhe 4) nuk do të vendosen në këtë faqe. Vlerat e zbatueshmërisë së tyre (100%) do të pasqyrohen automatisht në **grafikun 5**. Ndërkohë, **paragrafi 5 i nenit 33** nuk do të përfshihet fare në përllogaritje pasi Këshilli nuk ka patur rast ta referojë atë gjatë procesit vendimarrës të kohës nën monitorim.

2. MATJA DHE VLERËSIMI I ZBATUESHMËRISË SË NENIT 34 “MBLEDHJET E HAPURA”


Zbatueshmëria e **Dispozitës: b**, Para. 2, N. 34



Sa i takon paragrafit 2 të nenit 34, ai ka në vetvete 4 komponemë/dispozita përmes të cilave realizohet nga Keshilli njoftimi i mbledhjeve të tij, konkretisht: **a)** njoftim në vendin e caktuar, **b)** përmes medias, **c)** përmes website-it, **d)** tel/email.

Sa i takon dispozitës “**b**”, pra njoftimit përmes medias, rezuhori se nga 19 mbledhje këshillti të monitoruara, për 6 prej tyre është bërë njoftim paraprak në median lokale. Kjo do të thotë se zbatueshmëria e dispozitës në fjalë e shprehur në përqindje është: $6 / 19 \times 100 = 31.57\%$. Raporti i zbatueshmërisë së kësaj dispozitë jepet në **Grafikun 9**, (majtas).


Zbatueshmëria e **Dispozitave: a,b,c & d**, Para. 2, N. 34




a : ne vendin e caktuar
b : përmes medias

c : përmes website
d : përmes tel /email


Mesatarja e Zbatueshmërisë së **paragrafit 2, N. 34**



Zbatueshmëria e **gjithë paragrafëve** të NENIT 34



Zbatueshmëria vs. **Mos-zbatueshmëria** e NENIT 34



MBI VIZUALIZIMIN E TE DHENAVE PËR ZBATUESHMËRINE E NENIT 34 “MBLEDHJET E HAPURA”

Neni 34 ka 3 paragrafë. I treti mik ka hyrë astnjëherë në zbatim gjatë periudhës nën vlerësim nga ÇIP, rrjedhimisht zbatueshmërie e tij mik është pjesë e grafikut 12. Paragrafi 1 i nenit 33 rezulton i përmbrushur nga Këshilli Bashkiak, sa kohë që pjesëmarrja e qytetarëve të ndryshëm në mbledhjet e Këshillit, përvèç ZTC, ka qenë një konstante e përhershme.

Sa i takon paragrafit 2 të nenit 34, ai ka në vetvete 4 komponemë/dispozita përmes të cilave bëhet i mundur realizimi i njotimit të mbledhjeve, konkretisht: **a)** përmes njotimit në vendin e caktuar, **b)** përmes medias, **c)** përmes website-it, **d)** me tel/email. Secila nga mënyrat ka 25% peshë në vlerësimin e

zbatimit të paragrafit 2, nenit 33 (graf. 10).


Sa i takon dispozitës “**b**”, vlera e zbanieshmërisë së saj është 31.57% (grafikun 9).

Lidhur me “**a**”, zbatueshmëria është 0%, pasi stenda e njotimeve mik ka funksionuar, “**c**” është gjithashu 0%, pasi nga monitorimi i ëebshit, nuk rezulton që në të jenë hedhur njotime përmblodhjeje zhvilluara gjatë kohës nën monitorim.


Lidhur me “**d**”, grupi monitorues e prezumon atë të realizuar pasi, në rast të kundërt, edhe vetë këshilltarët do të kishin mundur në mbledhjet e këshillit bashkiak.

3. MATJA DHE VLERËSIMI I ZBATUESHMËRISË SË NENIT 35 "SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË"

Zbatueshmëria e Dispozitave: dh & f, P.1, N. 35





Zbatueshmëria e Paragrafit 3, N. 35 (publikimi i vendimeve)




PARA PROJEKTIT

Niveli i zbatueshmërisë së të gjithë paragrafeve të NENIT 35




PARA PROJEKTIT

Zbatueshmëria vs. Mos-Zbatueshmëria e NENIT 35



PAS 16 MUAJSH

GRAF. 19



MBI VIZUALIZIMIN E TE DHENAVE PËR ZBATUESHMERINË E NENIT 35 "SEANCA T E KËSHILLIMIT ME BASHKESINE"

Grafiku 14 paraqet zbatueshmërinë e dispozitive që i ngarkojnë Këshillit deputimin për konsulatin me publikun të Buxhetit vjetor dhe të Paketës Fiskale. Këto dispozita janë respektivisht gërmat "dh" dhe "f", që referohen nga paragrafi 1 (fjalia e dytë), e nenit 35, direkti prej nenit 32.

Cerim "e", e cila gjithashu përmendetet nga i njëjti paragraf, nuk përfshihet në vlerësim për arsy që janë shpjeguar në faqen 30. Kurse sa i zakon gërmës "k", Këshillinuk ka patur rast konkret për t'u referuar asaj gjatë kohës nën monitorim. Grafiku 15 paraqet zbatueshmërinë e dispozitives për afshimini e vendimeve (neni 35/3, fjalia e parë). Gjatë monitorimit u konstatuan vetëm 3 vendime të cilat u afshuan në stendën e bashkisë ne Maj 2011,



sipas kërkesave të nenit 35/3, ose 2 % e totalit prej 140 vendimesh (shih f. 32). Cjatë periudhës së projektit, Qendra ÇIP e restuaroi plotësisht këtë deputim ligjor të Këshillit përmes publikimit online të vendimeve në databazën e linjkuar në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Rrejdhimisht zbatueshmëria e kësaj dispozitë nga 2 % para projektit, u rrit në 100% në fund të tij (pas 16 muajsh).

Grafikët 16 dhe 17 tregojnë zbatueshmërinë e paragrafeve 1, 2 dhe 3 të nenit 35 respektivisht para dhe pas projektit. Paragrafi 35/2.1 nuk është i përfshirë në vlerësim pasi zbatueshmëria tij del jashë objektit gjeografik të monitorimit. Grafikët 18 dhe 19 vizualizojnë zbatueshmërinë e nenit 35 në tërësi, respektivisht para dhe pas projektit.

4. ANALIZA KRAHASUESE: ZBATUESHMËRIA E NENEVE 34 & 35 PARA DHE PAS PROJEKTIT



PARA PROJEKTIT

PAS 16 MUAJSH

Niveli i Zbatueshmërisë së **NENEVE 34 and 35** para dhe pas projektit (16 muaj)

PARA PROJEKTIT

PAS 16 MUAJSH

Mesatarja e zbatueshmërisë së të **NENEVE 34 dhe 35** ($a+b/2$), para dhe pas projektit (12 muaj)

MBI VIZUALIZIMIN E TE DHENAVE

Në kuadër të Metodës së zhvilluar nga CIP, mesatarja e vlerës së zbatueshmërisë (implementimit) së neneve 34 dhe 35 të marra së bashku indikon automatikisht dhe drejtëpërdrejt nivelin e transparencës në procesin vendimarrës të realizuar nga Këshilli Bashkiak.

Kjo vlerë mesatare është e mundur të matet në fillim dhe në fund të periudhës gjatë së cilës është ndërhyrë përmes projektit, sikurse shihet qartësisht në grafikët 22 dhe 23.

Eshë shume interesant fakti se ne perfundim te projektit, kemi një rezultate 50 me 50 sa i takon zbatueshmëri se perbashket te dy neve 34 dhe 35 te marra së bashku. Kjo rritje e gjeruar i atribuo-

het ne fakt vetem zbatimit 100 te njerëz prej dispozitive te nenit 35, pikërisht asaj që ka te heje me publikimin e akteve te Keshillit, te cilin Qendra CIP e adresoi për zgjidhje me ane te teknologjive te reja te informacionit, konkretisht përmes ndertimit te databazës online te vendimeve, 2007-2012.

Grafikët sipër tyre, konkretisht ai me nr. 20 dhe 21 vizualizojnë zbatueshmërinë veç e veç të këtyre dy neneve shumë të rëndësishme të ligjit 8652, të ndryshuar, si para ashtu edhe pas ndërhyrjes me anë të projektit në Korçë. Këto vlera janë përf tua nga llogaritjet respektive të zbatueshmërisë së neneve në fjalë (shiko më sipër tek fq. 48 dhe 49).

5. PËRLLOGARITJA E NIVELIT TË TRANSPARENÇËS DHE PËRMIRËSIMI I GJENERUAR NGA PROJEKTI

Neni 34 (*Mbledhjet e hapura*) dhe Neni 35 (*Seancat e këshillimeve me bashkësinë dhe e drejta e publikut përtu informuar*), i ligjit 8652, të ndryshuar i ngarkojnë Këshillit Bashkiak detyrimin për realizimin e një procesi vendimarrës të hapur dhe me pjesëmarrje, duke garantuar njëkohësisht aksesin të publikut në mbledhjet dhe vendimet e Këshillit (*shih: Pjesa e Parë*). Në këtë kuptim, zbatimi i këtyre neneve është kusht ligjor (juridik) dhe faktik për të vlerësuar transparencën e projektit vendimarrës në nivel lokal.


Në kuadër të Metodës së Zhvilluar nga ÇIP, mesatarja e zbatueshmërisë (implementimit) së neneve 34 dhe 35 të marra së bashku indikojnë automatikisht dhe drejtëpërdrejt nivelin e transparencës në procesin vendimarrës të realizuar nga Këshilli Bashkiak. Vetë Transparency, në kuadër të kësaj metode, është *apo definohet si një sintezë e 1) vendimarjes së hapur, 2) konsultimit paraprak të vendimarrësit me publikun dhe 3) garantimit të aksesit efektiv në mbledhjet dhe*

vendimet e Këshillit. Që të treja këto komponentë janë të shpërndarë nga ligjvënesi në nenet 34 dhe 35.

Krahasimi i vlerave të zbatueshmërisë mesatare në përqindje të dyja neneve 34 dhe 35 në fillim e në fund të projektit (graf. 19, 20) prodhon **Indikatorin e Rritjes së Transparencës**, shkurt IRT. Graf. 25 vizualizon qartë se Rritja e Transparencës së gjeneruar në Këshillin Bashkiak, Korçë është 17 pikë përqindje (50% - 33% = 17).

IRT është një indikator është sui-generis, i prodhuar nga ÇIP, përdoret për herë të parë me mjaft sukcese për vlerësimin e nivelit të transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjenë Korçë dhe Durrës. Ai mund të aplikohet në çdo Këshill Bashkiak për të matur dhe vlerësuar këto dy të fundit, madje edhe për të prodhuar një renditje (*ranking*) mes këtyre strukturave sa i takon ligjshmërisë dhe cilësisë së vendimarrjes në nivel lokal, mjafton të autorizohet nga ÇIP për përdorim.


Niveli i transparencës PARA dhe PAS ndërhyrjes së projektit në Korçë nga ÇIP



Si përfundim:

NE NJE SHKALLE ME 100 PIKE PERQINDJE, TRANSPARENCA E VENDIMARRJES NE KORCE U RRIT ME 17 PIKE

Indikatori i Rritjes së Transparencës (IRT)



MBI VIZUALIZIMIN E TE DHENAVE

Grafiku 24 është një vizualizim më i qartë i grafikëve 22 dhe 23. Kurse grafiku 25 vizualizon tre tregues njëkohësisht:

- 1) rrjeten e nivelit të zbatimit të neneve 34 dhe 35,
- 2) rrjeten e transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimarrje,
- 3) ndryshimin e sjellë në 16 muaj nga ÇIP në Korçë.

Rrjetimisht, Grafiku 25 është edhe indikatori kryesor matës për projektin. Ai mundëson vlerësimin objektiv të rrjetes apo të ndryshimit pozitiv të gjeneruar. Në rastin e Korçës, rrjetë prej 17 pikë përqindje e transparencës vendimarrëse është gjeneruar vetëm nga publikimi i vendimeve të Këshillit në format elektronik në databazën e krijuar dhe më pas dhuruar Bashkisë Korçë nga Qendra ÇIP. Kjo e rriti nga 0% në 100 zbatueshmërmë e paragjet 3 të nenit 35, të ligjit 8652 të udryshuar, i cili i ngarkon Këshillit Bashkiak detyrimin të afishojë / publikoje vendimet e tij.

Duhet theksuar se, paragrafi 3 i nenit 35 është ngushësish i

lidhur me paragrafin 6 i të nenit 33. Të dyja së bashku normojnë garantimin e aksesit në vendimet e Këshillit, një komponent ky i Transparencës, në kuadër të metodës vlerësuese të ÇIP. Përsye që nuk mund të kuptohen, ligjvënesi i ka shpërndarë këto dispozita që rregullojnë të njëjtin proces (informimin proaktiv të publikut) në dy nene të ndryshme (shih fq. 24-25). Për thjeshtësi metodologjike, paragrafi 6 i nenit 33 nuk është përfshirë në përllogarijen e nivelit të transparencës.

Rritja prej 17% e IRT është megjithatë relativisht e vogël, po të krahasohet me atë të Durrësit, i cili në 12 muaj u rrit me 50%, përmes të njëtave metoda që u implementuan fillimi të së ardhmes së korrikut (prill 2012) i vetë Këshillit Bashkiak për një vendimarrje transparente është një kusht esencial që IRT të pësoje rrjetë gjatë periudhës së projektit.

PJESA E KATËRT

**REKOMANDIME
DHE METODOLOGJIA**

4

REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet e monitorimit, Qendra ÇIP ka përpunuar edhe një sërë rekomandimesh të cilat mund të ndahen në tre grupe; ato që targetojnë ndryshime të mundshme në ligjin 8652, të ndryshuar, ato që adresojnë direkt Këshillin Bashkiak, Korçë, dhe ato që targetojnë organizmat jo-qeveritarë që punojnë në nivel vendor për promovimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje dhe të Qeverisjes së Mirë.

I. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Nga të dhënat e monitorimit rezulton një anashkalim konstant i procedurës që përcakton neni 33, pikë 1 e *ligjit 8562, të ndryshuar*, për votimin e fshehtë të vendimeve me karakter individual. Në rastin e Korçës kjo mund të diktohet nga infrastruktura e munguar në sallën ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo është një sallë “e marrë borxh”, pa infrastrukturë votimi.

Një arsy e dytë që mund të shpjegojë se përsë Këshilli Bashkiak, Korçë miraton përgjithësisht me votim të hapur vendimet më karakter individual, mund të jetë edhe njohja e paktë e dispozitave të *ligjit 8562, të ndryshuar* nga vetë këshilltarët. Këtë konsideratë e mbështet rasti i Durrësit, ku, edhe pse Këshilli zhvillon mbledhjet e tij në një sallë moderne, me infrastrukturë elektronike votimi, përsëri vihen re shkelje masive e dispozitës në fjalë. Në fakt, kjo mosnjohje e dispozitës në fjalë (*ignorantia juris*), e cila çon mandej në shkelje të saj, si në Korçë, ashtu edhe në Durrës, do të ishte e *disi e justifikuar* po të mbahet parasysh se nuk ka asnë manual, rregulllore, udhëzim apo vendim gjykate që të interpretojë dhe/apo caktojë kritere se çfarë dhe si dallohet një vendim individual nga një vendim normativ në Republikën e Shqipërisë.

I. REKOMANDIM:

Sa i takon prezumimit të parë, sipas të cilit dispozita për votimin e fshehtë të vendimeve individuale (neni 33/1) nuk zbatohet si rezultat i mungesës së një sallë të mirfilltë të pajisur me infrastrukturë elektronike votimi, zgjidhja e rekomanduar për problemin do të ishtendërtimi i një sallë të mirëfilltë ku të mund të zhvillohen mbledhjet e Këshilli Bashkiak të Korçës.

Bashkia Korçë duhet të hartojë me urgjencë një projekt për ndërtimin e një sallë të re, ose rikonstruksionin e ndonjë prej sallave ekzistuese pranë saj dhe të avancoje me shpejtësi drejt finalizimit të saj, për të lejuar Këshillin të zhvillojë një proces normal vendimarrës, të mbështetur në kërkesat e ligjit 8652. Konkrektisht, mund të adoptohej një nga sallat e ish-gjykatës së Korçës, e cila ndodhet pranë Bashkisë dhe të përshtatej si sallë plenare për mbledhjet e Këshillit. Kontributi i donatorëve do të ishtë shumë i vyer këtu.

Sa i takon prezumimit që niveli i ulët i zbatimit të dispozitave ligjore mund të vijë nga mosnjohja e mirë e vetë ligjit, një fushatë edukimi dhe ndërgjegjësimi ligjor, ku target kryesor janë këshilltarët, sekretarët e këshillave bashkiakë por edhe aktorët e tjera të interesuar, nevojitet të organizohet në kuadër të ndërhyrjeve në një nivel vendor. Synimi kryesor është rritia e cilësë dhe ligjshmërisë së procesit vendimarrës përmes krijimit të mundësive reale që ata të informohen mbi detyrimet ligjore të Këshillit në procesin vendimarrës, sidomos sa i takon vendimarrjes me së hapur dhe me pjesëmarrje, por edhe lidhur me publikimin e vendimeve të tyre (nenet 33, 34 dhe 35).

Po ashtu, ÇIP rekomandon ngritjen e kapaciteteve kontrolluese që Prefektët dhe administrata e tyre ushtrojnë mbi ligjshmërinë e vendimarjes së këshillave bashkiakë.

II. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Duhet theksuar se këshillat bashkiake në Shqipëri, nuk kanë një administratë të posaçme, e cila do të kujdesej për aspektet teknike të procesit vendimarrës. E gjithë barra për administrimin e procesit vendimarrës bie mbi një person të vetëm, që në këtë rast është Sekretari i Këshillit Bashkiak, i cili jo domosdoshmërisht ka një formim (apo trajnim) profesional juridik.

Kjo është një mangësi e cila ka komprometuar cilësinë procedurale të procesit vendimarrës në nivel lokal, siç e indikojnë edhe gjetjet e këtij Raporti. Mungesa e votimit të fshehtë rrezikon “infektimin” e procesit nga “influenca” partiake. Kjo do të shkonte së pari ndesh me interesin qytetar, për të cilin edhe vetë këshilltarët janë betuar solemnisht se do të advokojnë (dhe jo interesat e ngushta partiake).

II. REKOMANDIM:

Prania e një personeli të kualifikuar me formim profesional juridik që do të ndihmonte këshilltarët të respektonin aspekte procedurale të ligjislacionit për qeverisjen vendore (si psh. votimi i fshehtë, votimi me shumicë të cilësuar, etj), të cilat janë tashmë një problem që duhet adresuar për zgjidhje me urgjencë. Kjo mund të adresohej përmes amendimeve në **ligjin 8652, të ndryshuar**, ose përmes programeve të mbështetjes me burime njerëzore të kualifikuara, që mund të financohen nga donatorë të ndryshëm. Këto programe mund të pilotohen fillimisht në disa bashki kryesore, me synim implementimin e një tradite ligjshmërie. Këto programe, përveçse do të ndihmonin realisht në stabilizimin e një traditë të re ligjshmërie në vendimarrjen lokale, do të konstrubuonin indirekt edhe në punësimin e një personeli të kualifikuar, duke i shërbyer në këtë mënyrë një qëllimi të dyfishtë.

III. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Në kuadër të vlerësimeve në këtë seksion, CIP konsideron se shpërndarja në dy nene, konkretisht në nenin 33/6 dhe 35/3, e modaliteve për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të Këshillit Bashkiak/Komunal (*koha, vendi*), është një pakujdesi teknike e ligjvënësit, e cila, sikurse provohet edhe nga gjetjet, nuk i ka shërbyer implementimit korrekt të tyre.

III. REKOMANDIM:

CIP rekomandon që fjalia e parë e neni 35/3 “*Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre*”, të shtohet si pikë e shtatë (7) në nenin 33. Madje, edhe vetë kjo fjali mund të riformulohej më mirë, si psh: *Aktet e sapo-shpalluara të këshillit, në mënyrë që të marrin fuqi juridike, afishohen në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre*”.

Duhet theksuar se vetë shpallja si koncept implikon, për nga vetë përcaktimi, njoftimin e aktit subjekteve të cilave ju drejtohet akti. Sa kohë që publiku mungon përgjithësisht nëpër mbledhjet e Këshillave, shpallja, në mënyrë që të prezumohet e kryer, duhet të implikojë domosdoshmërisht edhe një vend në të cilin akti shpallet përmes afishimit apo publikimit. Vetëm në këtë mënyrë, mund të bëhej fjalë për një proces të kompletuar të informimit proaktiv të publikut nga vetë institucioni. Në fund të fundit, është Këshilli Bashkiak ai që ka interesin kryesor që vendimet që nxjerr të njihen nga qytetarët, me qëllim që ato të zbatohen.

Bazuar po në këtë llogjikë, CIP vlerëson gjithashtu se referanca që **ligji 8653, i ndryshuar** bën në **ligjin 8653**, “*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*”, është e panevojshme kur bëhet fjalë për njohjen e vendimeve të Këshillit me kërkësë eksplikite nga vetë qytetarët.

IV. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Njoftimi i aktiviteteve të këshillit bashkiak (të bashkisë në teresi) tek një numër i madh popullate është një sfidë me natyrë logjistike. Ligji 8652, i ndryshuar parashikon se "Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë..." Nga verifikimi në terren, siç u bë e qartë në këtë Raport, nuk janë konstatuar afishime në vende publike. Identifikime dhe më pas implementimi i sistemeve të reja për njoftimin e akteve të Këshillit tek sa më shumë qytetarë është në kushtet aktuale një domosdoshmëri jo vetëm ligjore, por edhe praktike. Në rast të kundërt, legjislativi i Bashkisë do të mbetet *de-facto* i distancuar nga qytetarët e vet teksa ushtron vendimarrjen në emër të tyre. Kurse këta të fundit, nuk do të janë *de-facto* qytetarë të mirë, sa kohë që, mosnjohja e vndimeve prej tyre mund të çojë në mos-zbatim të akteve.

IV. REKOMANDIM

Vendosja e dy-tre ekraneve "**LED**" në disa vende me qarkullim publik, do të adresonte mjaft mirë për zgjidhje problemin në fjalë. Këto do të shërbenin që aktet e Këshillit të zbatoheshim më mirë dhe qytetarët të ishim më mirë të informuar për detyrimet e tyre në raport me pushtetin vendor. Kujtojmë këtu që transparenca me publikun është njëkohësisht edhe aleati më i mirë i çdo të zgjedhuri dhe funksionari publik gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Për mbledhje të rëndësishme të Këshillit, siç mund të janë ato për Planin e Përgjithshëm Rregullues, Taksat dhe Tarifat Vendore, Buxheti vjetor, etj, do të ishte e dobishme edhe shpërndarja e njoftimit përmes fletpalosjeve të cilat më pas tju shpërndahen qytetarëve nëpër sheshet apo rrugëkalimet kryesore të Korçës. Rrjetet qytetare tashmë të ngritura (Rrjeti për Transparencë Qytetare i ngritur nga ÇIP) mund të ofronin anëtarët e tyre për realizimin e këtij lloj njoftimi tek sa më shumë qytetarë. Në rastin e këtyre mbledhjeve të rëndësishme të Këshillit, Ekranet "LED", mund të shërbenin për të transmetuar live diskutimet në seance plenare, duke shmangur edhe që në sallë të ketë mbi-popullim me qytetarë të interesuar.

V. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Akomodimi i publikut të interesuar në sallat ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak është një tjetër konstatim i Raportit. Problemet me natyrë infrastrukturore të sallave të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak janë të përhapura në Shqipëri. Kjo mangësi është akoma edhe më e madhe për ato bashki të cilat nuk kanë mundur dot të investojnë në ndërtimin e sallave bashëkohore për Këshillat Bashkiak, siç është edhe Korça,

Konstatohet se sallat e reja që janë ngritur edhe me kontriuin e donatorëve të rëndësishmëm, që punojnë në Shqipëri prej vitesh për të promovuar të drejtën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje nuk kanë kapacitete akomoduese për publikun dhe median (Durrësi, Tirana). Është e paspjegueshme, madje e kritikueshme që, në momentin kur këto parime të rëndësishme duhet të materializoheshin në produkte konkrete, qytetarët nuk kanë qenë pjesë e ekuacionit që zgjidhej. Kjo, përvèçse pushtetin vendor, ngarkon me përgjegjësi edhe vetë komunitetin donator që kanë financuar ndërtimin e *parlamenteve të qyteteve* që, përfat të keq, nuk mundësojnë efektivisht pjesëmarrjen direkte të publikut.

V. REKOMANDIM:

Për të adresuar problemin, ÇIP rekomandon që, në kuadër të amendimeve të mundshme të *ligjit 8652, të ndryshuar*, që pikës 1 të nenit 34, t'i shtohet edhe një fjali e tretë, në të cilën të përcaktohet në mënyrë eksplikite se: "Këshilli ka detyrim të garantojë infrastrukturën e nevojshme akomoduese për qytetarët e interesuar të ndjekin në sallë mbledhjet që ai zhvillon".

Sa i takon Korçës, duhet treguar kujdes që në rastin e ndërtimit të një sallë të re për Këshillin Bashkiak, të sigurohen kapacitet e duhura akomoduese për publikun. Sa i takon donatorëve të ndryshëm, projektet e finançuara prej tyre në drejtim të ngritjes së infrastrukturës së sallave të këshillave bashkiakë / komunalë, është mirë të vlerësohen që në fazën e projektimit sa i takon kapacitetet e aksesuuese për publikun e interesuar që ndjek mbledhjet në sallë. Do të ishte një demagogji që, nga njëra anë të synohej pjesëmarrja e publikut në vendimarrjen vendore, dhe nga ana tjetrë, sallat e reja ku Këshillat zhvillojnë aktivitet të mos kenë fare kapacitete akomodues për ta.

VI. PROBLEM I IDENTIFIKUAR

Databaza e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Koçë përmban të gjitha vendimet që prej vitit 2007. Databaza është linkuar në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Ajo garanton akses efikas në vendimet e Këshillit Bashkiak për të gjithë të interesuarit, në mënyrë të thjeshtë, pa pagesë dhe në çdo kohë. Databaza i vjen në ndihmë gjithashtu dhe Këshillit Bashkiak, i cili ka detyrimi ligjor të shpallë publikisht vendimet e tij.

Përdorimi i teknologjive të reja dhe hapja ndaj inovacionit është një ndër 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe Demokratike të Këshillit të Evropës. Aktualisht në RSH ka vetëm dy bashki që disponojnë databaza të rregullta online të vendimeve të Këshillit: Korça dhe Durrësi. Në të dyja rastet, databazat janë prodhuar dhe më pas i janë dhuruar Këshillave respektive nga Qendra për Çeshtje të Informimit Publik dhe degët e saj lokale, të quajtura Zyrat e Transparencës Qytetare

VI. REKOMANDIM:

Në mënyrë që procesi i hedhjes së vendimeve në datazën online të jetë i qëndryeshëm edhe pas përfundimit të projektit, një program për rritjen e kapaciteteve që targeton sekretarët e këshillave bashkiakë dhe personelin IT nëpër bashki është i nevojshmëm të ndërmeret. Skanera dhe pajisje të tjera që mundësojnë dixhitalizimin dhe hedhjen online të vendimeve të Këshillit duhet gjithashtu të vendosen në dispozicion të sekretarëve të këshillave dhe personelit IT.

Pse sekretarët e këshillave bashkiakë?

Sipas neneit 37, pika 2 e ligjit 8652, Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak është përgjegjës për:

- a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
- c) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga këshilli komunal ose bashkiak;
- d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;

Pse personeli IT?

Konform regulloreve të brendshme, personeli IT është përgjegjës për zhvillimin, mirefunksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve online dhe të rrjeteve kompjuterike. Është në fakt pjesë e detyrave funksionale të personelit IT, që, në bashkëpunim me sekretarin e këshillit bashkiak, të kryejë hedhjen online të të dhënave. Ky i fundit duhet të jetë automon. Këtë e mundëson pajisja e personelit IT me të drejtë admisnitrimi, të cilat delegohen në këtë rast nga ÇIP. Në këtë kuptim, IT-të e bashkive janë personel kyç për operimin automon të sistemit të databazës, këtë herë në mënyrë të decentralizuar (i ndërmarrë sipas nevojave përkatëse nga çdo bashki).

VII. PROBLEM I IDENTIFIKUAR

Gjatë periudhës kohore që mbulan ky monitorim, të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli kanë qenë me dyer të hapura. Nuk ka patur në asnjë rast votim për të zhvilluar seanca plenare më dyer të mbyllura.

Gjatë kësaj periudhe dy-vjeçarë që Qendra ÇIP është duke punuar në nivel të qeverisjes vendore, nuk është konstatuar në asnjë rast të vetëm zhvillimi i ndonjë mbledhje me dyer të mbyllura nga Këshilli Bashkiak, e cila të fuste në veprim këtë dispozitë (34/3).

VII. REKOMANDIM:

Qendra ÇIP vlerëson se dispozita 34/3 kontradikton me vetë frysës që mbart në të vërtetë ligji 8652, për një vendimarrje të hapur dhe me pjesëmarrje. Do të mjaftonte vetëm aplikimi rigoroz i votimit të fshehtë për të superuar çdo "përkujdesje" që dispozita në fjålë mundohet t'i sigurojë procesit vendimarrës. ÇIP rekomandon abrogimin e kësaj dispozite në kuadër të një amendimi të mundshëm që mund të pësojë në të ardhmen ligji 8652, i ndryshuar.

Sugjerim:

Inisiativat për promovimin e vendimarrjes me pjesëmarrje në nivel vendor po gjunjë gjithmonë e më tepër mbështetje nga donatorë të ndryshem në Shqipëri. Këto nisma janë orientuar deri më tanë drejt ndërgjegjësimit të qytetarëve përsa i takon të drejtave të tyre të pjesëmarrjes në vendimarrje si dhe drejt modelimit të një sjelljeje më të hapur të pushimetarëve lokalë ndaj publikut. Megjithatë ka një mosrakordim të këtyre nismave me kërkasat e ligjit 8652 të ndryshuar sa i takon përqasjes korrkte "veç e veç" ndaj funksioneve vendimarrëse dhe tyre ekzekutive në nivel vendor. Kjo mangësi duhet të vlerësohet me kujdes prej tyre në fazën e shqytimit prej donatorëve të projekt propozimeve të NGO-ve.

Qëndrueshmëria e mbështjës së nismave që targetojnë pushtetin lokal është një problem më vete. Për shkak të mentalitetit dhe traditës së muguar në qeverisjen e mirë në nivel vendor, nismat që synojnë njohjen, respektimin dhe rritjen e zbatueshmërisë së ligjit nga organet e qeverisjes lokale e kanë të nevojshme qëndrueshmërinë financiare. Në një rast të tillë duhet kuptuar se projektet të tillë kanë një target të dyfishtë: pushtetin vendor dhe qytetarët. Modifikimi i sjelljes së të dyja targetgrupeve kërkon kohën e vet, sidomos kur mungon vullneti dhe interesit nga vetë vendimarrësit lokalë për të qenë të hapur ndaj nismave që synojnë restaurimin e ligjshmërisë së vendimarrjes lokale.

METODOLOGJIA

Nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, janë mishërimi praktik i lidhjes organike që garanton një proces vendimarrës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Zbatimi rigoroz i këtyre neneve është kusht juridik¹ për të patur një vendimarrje transparente dhe të hapur ndaj publikut. Rrjedhimisht, matja e nivelit të implementimit të këtyre 3 neneve prodhon automatikisht indikatorë të drejprërdrejtë për vlerësimin objektiv të nivelit të transparencës nga vendimarrësit vendorë.

Zhvillimi i një metode për matjen e nivelit të zbatimit të këtyre tre neneve "të transparencës" dhe implementimi në praktikë i saj ka qenë një ndër objektivat kryesorë të këtij projekti. Kjo metodë e re monitorimi dhe vlerësimi u mor përsipër të zhvillohej nga Qendra ÇIP, në kuadër të një projekti integral i cili u implemen-tua në dy bashki kryesore, konkretisht në Durrës dhe në Korçë. Modeli metodologjik është i tipit "**Monitorim përmes Pjesëmarrjes**", ose shkurt **MP**.

Mjeti kryesor metodologjik qe u zhvilluar nga ÇIP u emërtuar **PROAKTIV** (akronim i modifikuar për: *Protokoll i Vleresimit te Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*). Ky protokoll është *sui-generis*, që do të thotë se është "*qepur pas trupit*" të legjisacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Në vija të përgjithshme, qasja PROAKTIV ndërthur në një bllok të vetëm **monitorimin e ligjshmërisë së procesit vendimarrës të Këshillit Bashkiak përmes pjesëmarrjes dhe raportimit aktiv qytetar**.

Në përgjithësi kjo Metodologji implikon ndërveprimin midis një strukture *grassroots* (ZTQ) dhe një organizate *think tank* (ÇIP). E para, në ndërveprimin e saj me strukturat në nivel lokal gjeneron të dhëna në terren të cilat i përcillën strukturës së specializuar në qendër përpunim, amplifikim, dhe gjenerim konkuzionesh. Substanca e kësaj analize është matja dhe vlerësimi i nivelit të zbatueshmrisë së ligjit nga strukturat lokale, objekt monitorimi (në rastin konkret Këshilli Bashkiak, Korçë). Nga ana tjetër, struktura "grassroots" ushqehet nga struktura Think Tank me një protokoll të detajuar mbi bazën e të cilët ndërtohet ndërveprimi me Këshillin Bashkiak.

Është me rëndësi të theksohet se kjo metodologji

bazohet mbi prezumimin se kuadri ligjor i cili normon procesin vendimarrës në nivel lokal dhe transparentë që duhet të bashkëshoqëroja atë, është i kompletuar dhe garantues. Në fakt kjo përkon me vlerësimin e përhapur se vende si Shqipëria kanë (adoptuar) legjislacion të mirë, dhe se problemet e hasura burojnë nga implemetimi i pamjaftueshëm (i keq) i këtij legjislacioni.

PËRSHKRIMI I DETAJUAR I PROAKTIV

Një grup prej 7 qytetarësh, të cilët përfaqësonin shtresa, profesione dhe grupmosha të ndryshme, u përzgjodhën dhe u trajnuan nga Qendra ÇIP për përdorimin autonom të disa prej hallkave të PROAKTIV. Përveç ndjekjes në sallë të çdo mbledhjeje të Këshillit Bashkiak për të testuar kështu konkretisht garantimin e të drejtës së publikut pjesëmarrje, ata do të mbledhnin të dhëna edhe për disa hallka të procesit vendimarrës që normohen nga dispozitat e shperndare ne nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Është e qartë se në këto kushte, procesi monitorues i këtij ekipi mikë qytetarësh, që u identifikuani me emrin "Zyra e Transparencës Qytetare, Korçë", nuk limitohet brenda sallës dhe kohës në të cilën zhvilloheshin mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Përkundrazi, një pjesë e rëndësishme e këtij procesi zhvillohej para apo pas përfundimit të këtyre mbledhjeve, (në kohën që projekt-aktete duhet t'i nënshtroheshin konsultimit me komunitetin para se ato të kalonin në votim, apo edhe kur vendimet tashmë të marra duhej të shpalleshin përmes publikimit dhe të hynin në fuqi).

Një reporti i hartuar nga team leader dhe i "kolauduar" nga anëtarët e ZTQ, Korçë pas përfundimit të çdo mbledhjeje të Këshillit Bashkiak, i dërgohej Qendrës ÇIP për vlerësimë të mëtejshme (*shih dy Raporte në Aneksin 2*). *Template* i këtij reporti, përcaktuar nga ÇIP, synonte mbledhjen e të dhënave si: *prezenca e këshilltarëve bashkiakë në sallë, vendimet e miratuara, rezultati i votimit, axhenda e paralajmëruar e mbledhjes dhe modifikimet e saj në seancë plenare, etj.*

Të dhënat e këtij reporti riorganizoheshin përmblehdhata edhe në formatin e një lajmi gazetaresk, i cili më pas publikohet *on-line*, në faqen zyrtare të Qendrës

ÇIP, www.infocip.org, tashme e linkuar në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Ky rapport në stil gazetaresk i shërbente dy qëllimeve: Së pari ai ofronte një mundësi të parvarur informimi për cilindo qytetar, përdorues interneti, përfshirë edhe vetë administratën e bashkisë për të ndjekur në kohë reale aktivitetin e këshillit bashkik në këndvështrimin e një procesi te monitoruar nga shoqëria civile (ZTQ, Korçë). Së dyti, ky lloj raportimi i shërben edhe promovimit të një kulture raportimi meditik online nga vetë qytetarëtë përfshirë në nisma vendore monitoruese. Kjo kulturë e re shkon në një hap me prezantimin e mënyrave novatore përritje të transparencës përmes **neë media** apo mjeteve të reja teknologjike që sot gjithmonë e më shumë janë në dispozicion të operatorëve të shoqërisë civile (*shiko: www.infocip.org*).

Po ashtu, për të garantuar vlerësimin sa më të detajuar dhe objektiv nga ekspertët e ÇIP në Tiranë, të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, të zhvilluara në periudhën kohore të mbuluar nga ky projekt, dokumentoheshin në audio-video. Ky dokumentim rigoroz² është shumë i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar të modaliteteve ligjore të vendimarrjes ndërmarrë nga ÇIP, konkretisht, sa i takon përcaktimit të nivelit të implementimit të dispozitave ligjore që janë objekt monitorimi në kuadër të këtij projekti, konkretisht nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar Pas konvertimit të kasetave filmike në format dixhital nga ÇIP dhe përfundimit të kqyerjes së kujdeshme të tyre, të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Korçë, *upload-heshin* në faqen zyrtare të ÇIP. Kjo përfaqëson një vlerë të shtuar metodologjike dhe te projektit ne tërësi pasi, i jep mundësi në rradhë të parë autoriteve lokale në Korçë të verifikojnë efektivisht saktësinë e gjetjeve si te raporteve periodike pas çdo mbledhjeje ashtu edhe te raportit final.

Bazuar mbi të dhënat e grumbulluara përmes PROAKTIV, ekipi i ekspertëve të ÇIP në Tiranë, pas një përpunimi rigoroz të tyre, ka vlerësuar hap pas hapi të gjitha dispozitat që përbajnjë nenet 33, 34 dhe 35.

Në kuadër të kësaj metode, **mesatarja e zbatueshmërisë** së dy neneve 34 dhe 35 të marra së bashku indikon nivelin e Transparencës në Vendimарjen Lokale, pasi dispozitat që ato përbajnjë, nëse zbatohen rigorozisht garantojnë pjesëmarrjen e plublikut **para, gjatë** dhe **pas vendimarrjes** së këshillit bashkiak.

Krahasimi i mesatares së zbatueshmërisë së këtyre dy neve (34 & 35) para fillimit të projektit dhe në përfundim të tij indikon apo përshkruan edhe përmirësimin e nivelit të transparencës (hapje + vendimarije e konsultuar me publikun + informim proaktiv) të gjenuerar si rezultat i ndërhyrjes përmes projektit. Dy vlerat e krahasuar (në fillim dhe në fund të projektit), nëse diferencohen mes tyre teksa janë të vendosura në një

shkallë përqindjeje, prodhojnë një indikator të posaçëm, të quajtur Indikatori i Rritjes së Transparencës (IRT). Ky indikator përdoret për të vlerësuar njëkohësisht rritjen e zbatueshmërisë së dy neneve 34 dhe 35 të marra së bashku si edhe impaktin e gjeneruar nga snergjia mes operatorit të shoqërisë civile (në rastin konkret të ÇIP dhe degës së saj lokale në Korçë, ZTQ) dhe Këshillit Bashkiak (në rastin konkret KB Korçë).

MATRICA E MATJES & VLERËSIMEVE

Matrica e Matjes & Vlerësimit është mekanizmi bazë që "filtron" të gjitha dispozitat e matshme të neneve 33, 34 dhe 35.

Pasi i identifikon dhe i veçon dispozitata, ajo poneron secilën prej tyre me përqindje në vlerësimin përfundimtar të nenit përkatës.

Matrica, gjithashtu përjashton ato paragrete, apo dispozita të cilat nuk mund të janë objekt vlerësimi përsye që lidhem kryesisht me mos-hasjen e tyre në praktikën vendimarrëse të Këshillit (shënuar me të kuqe).

Konkretnisht, nëse një nen ka 6 paragrafë (*psh. nen 33*), atëherë secili prej tyre ka 16.6 pikë përqindje në vlerësimin e zbatueshmërisë së tij ($16.6\% \times 6 = 100\%$). Nëse ndonjë nga këta paragrafë nuk është referuar në praktikën vendimarrëse të Këshillit, pasi situata parashikuar prej paragrafit në fjale nuk është hasur gjatë periudhës nën monitorim, atëherë, ky paragraf nuk përfshihet (ekskludohet) në procesin e vlerësimit të zbatueshmërisë së nenit. Pesha specifike e tij në vlerësim shpërndahet tek paragrafët e tjera të nenit. Konkretnisht, në nenin 33, parografi (pika) 5, i cili parashikon rivotimin për kryetari, zv. kryetarin dhe sekretarin e këshillit kur nuk arrihet shumica e kërkuar, nuk hyri asnjëherë në veprim gjatë periudhës nën monitorim. Këshilli i ri Bashkiak i cili doli pas zgjedhjeve të 8 Majit 2011, zgjodhi drejtuesit e vet që në raundim e parë të votimit. Prandaj, parografi 5 i nenit 33 nuk përllogaritet në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit. Pikët e tij shpërndahen tashmë në 5 paragrafët e tjera, duke bërë që këta të fundit tashmë të kenë secili një peshë specifike në vlerësim prej 20 pikë përqindje ($100\% / 5 = 20\% =$).

Shpjegime të hollësishme lidhur me mënyrën e realizimit të matjes, vizualizimin e të dhënave dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së dispozitave, paragrafëve dhe neneve 33, 34 dhe 35 janë ofruar në çdo faqe të Pjesës III të Raportit.

Vetë Matrica (fq. 45) është një asset metologjik parësor dhe reflekton ekspertizën e thellë të akumuluar tashmë nga ÇIP në drejtim të matjes dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së dispozitave ligjore që normojnë çështje të informimit proaktiv në veçanti dhe të Transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në tërësi.

ANEKS NR.2

Më poshtë janë paraqitur dy raporte, të hartuara secila nga dy team leader të ndryshëm, pas përfundimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Këto raporte, i dërgoheshin Qendrës ÇIP për vlerësimë të mëtejshme. Template i këtij reporti paracaktohej nga ÇIP. I plotësuar nga ZTQ, Korçë, ai synonte mbledhjen e të dhënave si: prezenca e këshilltarëve bashkiakë në sallë, vendimet e miratuar, rezultati i votimit, axhenda e paralajmëruar e mbledhjes dhe modifikimet e saj në seancë plenare, etj.

QENDRA PER ÇESHTJE TE INFORMIMIT PUBLIK ZYRA KORÇË

Raport për mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Korces

Hartuar nga: Ritvan MECOLLARI

Korce, 26.3.2012

Përbledhje

Për Rikonfirmimin e vazhdimit të procedurave të kreditimit të familjeve të pastreha të miratuar nga këshilli i bashkisë përfekt vonese në banke.

Për miratimin e marrëveshjes se bashkepunimit midis bashkise Korce dhe fondacionit Shqiptaro-Amerikan përf zhvillimin dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë përf nënshkrimin e saj.

Për kalimin në privatizim.

Për rishikimin e V.KB Nr. 2 datë 13.02.2012 per nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre në qytetin e Korçës si dhe penalitetet përf shkeljet apo kundërvajtjet administrative përf vitin 2012.

Mbi strukturen e Bashkisë Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në Varësi.

Mbi miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë përf vitin 2011.

Mbi miratimin e Bxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë përf vitin 2012.

Shtoja

Në këtë rend dite u shtua dhe një pike "Për dhënien e ndihmës ekonomike" e cila u diskutua në fillim të mbledhjes.

SHËNIME

1. Hyrje

Këshilli Bashkiak i Korces ka zhivilluar mbledhjen rradhës ne daten 26.03.2012. Mbledhja ka filluar 30 minuta me vonese. U be prezantimi i Rendit te Dites i cili u miratua bashike me një pike shtese qe kishte te bente me dhenien e ndihmës ekonomike.. Pjesmaria ishte 18 anetare te Aleances per te Ardlumen dhe 14 anetare kishte Aleanca per Qytetarin. Perpara se te fillonte shqyrtimi e pikave te rendit te dites u be një propozim nga ana e Kryetares se aleances per qytetaret Jonela Spaho e cila kerkoi që pika 7 e reudit të dites" Mbi miratimin e Bxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë përf vitin 2012" të mos merrej në shqyrtim nga këshilli i Bashkisë në këtë mbledhje përf arsy se rend i ditës ishte shumë i ngarkuar pasi në kete mbledhje do të vendoset dhe diskutohej mbi miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë përf vitin 2011. Pas kësaj rendi ditës u miratua sic ishte me votat e këshilltareve te majtë. Pas kesaj filloj mbledhja ku u diskutuan si me poshtë pikat :

1. Per miratimin e ndihmës ekonomike.

Në lidhje me këtë pike diskutuan Jonela Spaho, Arjana Pupa dhe Pëllumb Beqiri dhe Irena Nikaj në lidhje me disa aspekte proceduriale përf dhënien e ndihmës si dhe përf numrin e përfituesve të ndihmës. Pas diskutimeve kjo pike u miratua anonimisht nga te gjithe keshilltaret.

2. Per Rikonfirmimin e vazhdimit të procedurave të kreditimit të familjeve të pastreha të miratuar nga këshilli i bashkisë përf efekt vonese në banke.

Në lidhje me këtë pikë foli z. Vaskë Thimio nga Drejtoria e Përkrahjes Sociale i cili dha sqarimet e nevojshtme përf procedurat të kreditimit të familjeve të pastreha. Mbas tij e morrën fjalën Znj. Arjana Pupa dhe z. Pëllumb Beqiri të cilët diskutuan rrëth kësaj pike dhe kërkuan sqarime nga kryetari komisionit të strehimit i cili dha sqarimet përkatëse. Pas diskutimeve kjo pike u miratua anonimisht nga te gjithe keshilltaret.

3. Për miratimin e marrëveshjes se bashkëpunimit midis bashkise Korce dhe fondacionit Shqiptaro-Amerikan për zhvillimin dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e saj.

Në këtë pikë u kryen diskutime të shumta ku fjalën e mori i pari z. Pëllumb Beqiri i cili shprehu kundërshtimin e tij në lidhje me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje pasi sipas tij nuk kishte transparencën e nevojshme. Në mbështetje të z. Beqiri u ngritën dhe folën Jonela Spaho, Arjana Pupa dhe Ilir Baljozi të cilët kérkuau informacion shtesë për këtë marrëveshje. Pas kësaj e mori fjalën disa herë z. Niko Peleshi i cili tha se kjo është një marrëveshje me interes per qytetin e Korçës duhet firmosur sa më shpejt pasi me këtë marrëveshje qyteti i Korçës do të përfitojë fonde për punime në infrastrukturën e tij. Kryetarin e Bashkisë e mbështetën dhe Irena Nikaj, Niko Pandeli, Raçi Themeli. . Pas diskutimeve kjo pike u miratua

4. Për kalmimin në privatizim.

Kjo pike kishte te bente me një kerkese per privatizimin e një godine shteterore nga familja e z. Gura i cili e posendon te prej vitesh. Kjo kerkese u miratua nga te gjithe keshilltaret unanimisht. Gjithashtu kishte dhe një kerkese tjeter per privatizimin e një godine që i perket qendres shendetesore nga familja e z. Enver. Ketu pati diskutime dhe disa keshilltare shprehën kundershtimin e tyre në lidhje me privatizimin e kësaj godine si znj. Arjana Pupa, Roza Petri, Pëllumb Beqiri, Raçi Themeli si dhe z. Niko Peleshi pasi ky privatizim binte ndesh me dizpozitat ligjore. Si përfundim kjo kërkesë nuk u miratua nga keshilltarët sitë majtë dhe të djathë.

5. Për rishikimin e VKB Nr. 2 datë 13.02.2012 per nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre në qytetin e Korçës si dhe penalitetet për shkëlfjet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2012.

Në lidhje me këtë pikë pati diskutime të shumta. Në fillim folën keshilltarët e djathë znj. Arjana Pupa, Pëllumb Beqiri, Jonela Spaho dhe Ilir Bajlozi. Këta keshilltarë theksuan faktin që paketa fiskale për vitin 2012 ka taksa dhe tarifa shume të larta të cilat vështirësojnë bisnezin dhe qytetarët dhe që kjo pakete u miratua pa u konsultuar me qytetaret. Në kuadrin e këtyre diskutimeve mori fjalën dhe Kryetari i Bashkisë i cili shpjegoi se kjo paketë fiskale nuk është e padrejtë për qytetarët por taksat dhe tarifat janë vendosur në përputhje me standartet e qytetit dhe se gjendja ekonomike e vështirë e qytetarëve dhe e bisneztit nuk vjen si pasojë e paketës fiscale por të kritës ekonomike që ka mbërryher Shqipërinë dhe githë botën. Si përfundim kjo pikë pas diskutimeve u votua vetëm me votat e keshilltarëve të majtë.

6. Mbi strukturen e Bashkisë Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në Varësi.

Në lidhje me këtë pikë pati disa diskutime. Përsa i përket strukturës së administratës së Bashkisë folën znj. Arjana Pupa, Pëllumb Beqiri, Jonela Spaho, Thanas dhe Ilir Bajlozi të cilët shprehën shqetësimin e tyre pasi sipas tyre struktura e administratës së Bashkisë Korcë është e fryrë dhe duhet të rishikohet. Z. Niko Peleshi tha që në këtë strukturë janë bërë shkurttime pasi janë shkrirë drejtori dhe janë bashkuar me të tjera. Në lidhje me strukturën e

Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në Varësi përsëri keshilltarët e djathë përmes kryetares së grupit znj Jonela Spaho kérkuau sqarime në lidhje me propozimin për shkurtimin e 12 pozicioneve në sektorin e gjelbërimit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike pasi këto shkurttime janë të pajustifikuara ndërkokë që më përpara janë miratuar shtime pozicionesh në këtë sektor. Z Niko Peleshi sqaroi se këto shkurttime propozohen për shkak të uljes së fondeve. Pas diskutimeve kjo pike u miratua por 2 keshilltarë votuan kundër.

7. Mbi miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë për vitin 2011.

Në këtë pikë pati përsëri diskutime të shumta. Fjalën e mori z. Pëllumb Beqiri i cili shprehu mendimin e tij se analiza e Buxhetit Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë për vitin 2011 është e mangët dhe jo e saktë. Në këtë analizë vërehet se shumë të ardhura nuk arrijnë të realizohen dhe transferohen për një vitin tjetër dhe nuk ka shpjegime të mjaftueshme për shpenzimet që kryen. Foli dhe z. Ilir Bajlozi i cili tha se raporti i shpenzimeve që kryen për fonde dhe për shpenzime operative nuk është i duhur. Harxhohen sipas tij më sa vjen e më shumë për shpenzime operative se sa per fonde investim. Z. Niko Peleshi përsëri dha shpjegimet e tij dhe sqaroi se fondet për investime janë ulur dhe ngriti problemin me kuotën që Bashkia i detyrohet Qarkut.

Shpjegime në lidhje me analizën e Buxhetit dha dhe znj Valbona Ziko Drejtoreshë e Financës të Bashkisë. Znj. Jonela Spaho foli dhe theksoi se disa nga punët publike në qytet për vitit 2011 si pastrami dhe mirëmbajtja e rrugëve nuk janë kryer nga firmat përkatëse në nivelin e duhur. Pas diskutimeve znj. Spaho bëri dhe një deklaratë ku propozoi përsëri që pikë 7 e rendit të ditës të mos shqyrtohej në këtë mbledhje por në atë pasardhëse. Si përfundim kjo pikë u miratua me votat e keshilltarëve të majtë.

8. Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve te Varësisë për vitin 2012.

Përpara se të fillontë shqyrimi i kësaj pike keshilltarët e djathë u larguan në shenjë proteste duke qenë se nuk u mor parasysh propozimi i bërë nga ana e tyre. Pas kësaj morrën fjalën z. Ilia Jatagani, Irena Nikaj, Niko Pandeli dher Thanas Tona. Në përfundim kjo pikë u miratua vetëm me votat e keshilltarëve të majtë.

Me kete votim u myll dhe mbledhja e Keshillit te Bashkise Korce oren 2.05 am.

11. Monitorimi I mbledhjes nga ZTQ Korce

Anetaret e ZTQ Korce, ,monitoruan edhe kete takim. Pjesetaret e ekipit po behen me profesionale per te ndjekur ate c'ka duhet monitoruar ky takim.Aktivizimi I tyre eshte rritur ndjeshem dhe diskutimi pas takimit ,ne analizen e punes se grupit eshte shume efikas per mbarevajtjen e ketij procesi.Takimi u filmua sipas kerkesave qe lejojne nje monitorim te

sakte, per te evidentuar te gjithe treguesit e kerkuar nga ana jone, si dhe te jetë sa me e qarte per qytetarin.

Ashtu si dhe theksuan ne fillim, mbledhjet fillojne me vonese, ka mungesa te keshilltareve. Ka nderhyrje gjate diskutimeve si dhe diskutime te shumefishta per nji pike te rendit te dites nga I nejeti keshilltar. vazhdojne te sillen material nga administratieve e bashkise, pa u diskutuar me pare ne komisione. Grupi I punes ka ndjekur shpalljen e vendimeve te marra nga Keshilli Bashkiak. Nga verifikimi I perditeshem I stendes per shpalljen e vendimeve dhe fotografimi I tyre, eshte konstatuar se prej konstituinit te ketij keshilli, nuk eshte shpallur asnjë vendim ne kete stende apo ne media.

Bashkangjitur po ju dergojme te detajuara, diskutimet per cdo pike te rendit te dites.

Korçë më 02.08.2011

RAPORT

MBI MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË DATË 28.07.2011

Hartuar nga Aleksander Dino

Ditën e Enjte më datë 28.07.2011 në orën 10.00 u hap mbledhja e Keshillit të Bashkisë Korçë. Mbledhja u zhvillua si gjithmonë në ambientet e Bibliotekës ‘Thimi Mitko’ Korçë e hapur për publikun.

Të pranishëm në mbledhje ishin 30 nga 35 këshilltarë gjithsej, përkatësisht: 15 këshilltarë që i përkasin Partisë Socialiste përfshi këtu Kryetarin dhe Nën Kryetaren e Keshillit, 7 këshilltarë që i përkasin Partisë Demokratike, 2 Këshilltarë që i përkasin Lëvizjes Socialiste për Integrin, 1 Këshilltar që i përket Partisë Republikane, 1 këshilltar që i përket Partisë Social Demokrate, 1 këshilltar që i përket Partisë Demokracia Sociale, 1 këshilltar që i përket Partisë Demokristiane, 1 këshilltar që i përket Partisë Ballit Kombëtar, 1 këshilltar që i përket Partisë Bashkimi Liberal Demokrat dhe 1 këshilltar që i përket Partisë për të Drejtat e Njeriut. Mungonin 3 këshilltarë të Partisë Socialiste dhe 1 këshilltar i Partisë Demokratike.

Përsa i përket pjesëmarjes së mediave të pranishme qenë 3 media televizive lokale përkatësisht Televizioni Publik ‘Korça’, Televizioni Privat ‘Maxhik Star’ dhe Televizioni Privat ‘Lobi’. Gjithashtu të pranishëm ishin dhe Kryetari i Bashkisë, Nënkyetari i Bashkisë dhe disa drejtore të drejtoreve të Bashkisë Korçë. Pjesëmarja e publikut ishte e pakët.

Rendi i ditës së mbledhjes së Keshillit të Bashkisë ishte si më poshtë vijon :

1. Mbi shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres tek Sh.A “Tregu i shitjes me shumice te fruta perimeve” Korçë.
2. Mbi shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres te Sh.A “Ujeselles Kanalizime” Korçë.
3. Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe Institucioneve te Vartesise per vitin 2011.
4. Te ndryshme.

Në bazë të ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000 neni 31 pika 7 “Mbledhja e këshillit komunal ose bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjeter përmarrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 33 të këtij ligji. Pjesëmarja e këshilltarëve për sa u përket miratimit të këtyre pikave ishte konform ligjt ndaj dhe mbledhja mund të zhvillohej.

Mbledhjen e çeli Kryetari i Keshillit z. Ilir Pendavinji i cili kërkoi të miratohej rendi i ditës së bashku me dy shtesa e para “Mbi strukturen dhe pagat e qendres ekonomike te kultures Vangjush Mio”. dhe e dyta një kerkese nga një grup keshilltaresh e cila ka te beje me miratimin e studimit urbanistik te qendres se qytetit.

Votimi 30 vota pro, 0 kundër 0 abstenim.

Miratohet rendi i ditës.

► Kalohet ne pikën e pare te rendit te dites e cila eshte “Mbi shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres tek SH.A “Tregu i shitjes me shumice te fruta perimeve” Korçë. Në këtë pikë Keshilli i Bashkisë funksionon me cilësinë e Asamblese se Aksionereve.

-Fjalën e merr znj. Arjana Pupa (këshilltare e djathtë dhe drejtore e Tregut te shitjes me shumice te fruta perimeve) e cila shprehet per punen e mire te anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe kerkon shkakun pse do te pushohen ata.

-Fjalën e merr z.Olsi Ekonomi (kryetar i grupit të këshilltarëve të majtë) i cili shpjegon arsyet për këtë ndryshim te anëtarëve të Keshillit Mbikqyres dhe gjithashtu propozin që numri i anëtarëve nga tre të bëhet pesë.

-Fjalen e merr z.Pellumb Beqiri(këshilltar i djathtë) i cili shprehet se nuk ka asnje arsy për shkarkimin e anëtarëve si dhe përritjen e numrit të tyre nga 3 në 5. Gjithashtu kërkon dhe bazueshmërinë ligjore për këë veprim.

-Fjalen e merr znj. Anxhela Dishnica (Drejtore e Drejtorisë Juridike të Bashkisë) e cila thotë : Bazueshmeria ligjore eshte ligji 9901 per shoqerite tregetare, neni 135, pikë 2c. Per sa i perket shkaqeve, ligji nuk parashikon asgje keshtu qe mund te jene dhe ato qe permendi z.Ekonomi.

Diskutohet nga keshilltaret rrëth kesaj pike.

-Fjalen e merr znj. Jonela Spaho (kryetare e grypit të këshilltarëve të djathtë) e cila shprehet se ne si grup nuk do te marrim pjesë ne votim per asnjë nga dy pikat e para te rendit te dites, si per shkarkimin por dhe per emerimin e anetareve te Keshillave Mbikqyres te dy SH.A-ve sepse eshte e pa argumentuar arsyja pse Keshilli Mbikqyres tek Tregu do te behet me 5 anetare kur ju vete jeni shprehur se nuk ka te ardhura nga kjo SH.A, shkaku i shkarkimit nuk u tha, po ashtu nuk patem konsensus me ju qe nje nga anetaret e K.Mbikqyres te kesaj Sh.A- je te jete nga ne. Ju keni folur per konsensus ne emer te bashkeqeverisjes por deri tani ate nuk e kemi pare. Ne do ta bojkotojme votimin.

Z.Peleshi shprehet rrëth kesaj pike por dhe per buxhetin

Kalohet ne votimi të fshehte per shkarkimin e anetareve te K.Mbikqyres tek Tregu me shumice i fruta perimeve. Ngrihet komisioni i votimit por pa pjesëmarrjen e këshilltarëve te djathtë.

-Fjalen e merr z.Agim Kacani (kryetar i grupit të votimit)

Mbas votimit u arrit ky rezultat:

Ne Votim morren pjese 18 keshilltare,u gjeten 18 vota te vlefshme, nga keto z.Pellumb Beqiri, z.Vangjush Dishnica dhe z.Kristi Ngjela morren pro shkarkimit te tyre nga 17 vota secili dhe nga 1 kunder. Keshtu qe komisioni i votimit shpall shkarkimin e tre anetareve te Keshillit Mbikqyres te “T.SH.SH.F P”.

-Fjalen e merr z.Ilir Pendavinji

Pra u shkarkuan tre anetaret e tregut me shumice.

Votohet për propozimin e z.Ekonomi qe Keshilli Mbikqyres ne T.SH.SH.F.P” SH.A te ndryshoje nga 3 ne 5 anetare.

Votimi 18 vota pro,0 kunder,0 abstenim

(Ne votim morren pjese 18 keshilltare gjithsej)

Kalohet ne propozimin e 5 kandidaturave per anetarë ne kete Këshill Mbikqyres.

Grupi i majte propozon keto emra: **Nikollaq Pandeli, Ilia Jatagani, Vasil Nemce, Altin Cenolli dhe znj.Sofjola Kotelli.**

Fjalen e merr z.Agim Kacani (kryetar i grupit të votimit)

Mbas votimit u arrit ky rezultat:

Ne Votim morren pjese 18 keshilltare, u gjeten 18 vota te vlefshme, nga keto z. Nikollaq Pandeli, Ilia Jatagani,Vasil Nemce, Altin Cenolli dhe znj.Sofjola Kotelli morren pro emerimin te tyre nga 18 vota secili . Keshtu qe komisioni i votimit shpall emerimin e 5 (pese) anetareve te rindje te Keshillit Mbikqyres te “T.SH.SH.F P”.

-Fjalen e merr z.Ilir Pendavinji

Pra u emeruan 5 anetaret e tregut me shumice.

► Kalohet ne piken e dytë te rendit te dites e cila eshte “Mbi shkarkimin dhe emerimin e anetareve te rindje te Keshillit Mbikqyres te Sh.A “ Ujesjelles Kanalizime” Korce.

Emrat e anetareve qe do te shkarkohen jane **z.Ilir Hoxha, z.Servet Feka, z.Riza Ashimi dhe znj.Elfrida Zefi.**

Kalohet ne votimi i fshehte per shkarkimin e 4 anetareve te sipercuruar me lart. Komisioni i votimit nis punen.

Fjalen e merr z.Agim Kacani (kryetar i grupit të votimit)

Mbas votimit u arrit ky rezultat:

Ne Votim morren pjese 18 keshilltare, u gjeten 18 vota te vlefshme, nga keto z.Ilir Hoxha, z.Servet Feka, z.Riza Ashimi dhe znj.Elfrida Zefi morren pro shkarkimit te tyre nga 18 vota secili, asnje kunder. Keshtu qe komisioni i votimit shpall shkarkimin e 4 anetareve te Keshillit Mbikqyres tek "Ujeselles Kanalizimet Korce SH.A"

Kalohet ne propozimin e 5 kandidaturave per anetar ne kete K.Mbikqyres.

Grupi i majte propozon keto emra: **Sotiraq Filo, Xhorxhi Saro, Petraq Premti, Artur Qeramixhi dhe Gjergji Gullamaci.**

Kalohet ne votimi të fshehte.

Fjalen e merr z.Agim Kacani (kryetar i grupit të votimit)

Mbas votimit u arrit ky rezultat:

Ne Votim morren pjese 18 keshilltare,u gjeten 18 vota te vlefshme, nga keto z.Sotiraq Filo, Xhorxhi Saro, Petraq Premti, Artur Qeramixhi, Gjergji Gullamaci morren pro emerimit te tyre nga 18 vota secili . Keshtu qe komisioni i votimit shpall emerimin e 5 (pese) anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres tek "Ujeselles Kanalizimet Korce Sha.".

► Kalojme ne pikën e tretë të rendit të ditës "Mbi strukturen dhe pagat e qendres ekonomike te kultures Vangjush Mio".

Fjalen e merr z.Vladimir Topi (drejtor i Qendrës ekonomike te kultures Vangjush Mio) i cili thotë se Qytetit te Korces ju shtua dhe nje muze qe mban emrin e Gjon Milit dhe kerkohet nje punonjes specialist per kete muze te ri. Diskutohet nga keshilltaret te cilet japim argumenta pro dhe kunder ketij propozimi.
Materiali kalohet në votim.

Votimi 18 vota pro,8 kunder,0 abstenim

Miratohet kjo pike.

► Kalohet ne pikën e katërt të rendit te dites e cila eshte " Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe Institucioneve te Vartesise per vitin 2011.

-Fjalen e merr z.Olsi Ekonomi (kryetar i grupit të këshilltarëve të majtë) i cili shprehet

Ne kemi folur shume per kete buxhet keshtu qe nuk dua te zgjatem per te, kemi vetem nje shkurtim te transferues te pakushtezuar (shkresa me nr 14820 date 22.07.2011 e Ministrit se Financave) ne vlore prej 5.173 000 lek. Nga ana e Drejtorisë se Finances kjo eshte ndare si shkurtim perkatesisht ne 3.801.000 lek ne shpenzime operative, 372.000 lek ne fondi rezerve dhe 1.000.000 lek ne investime. Buxheti te miratohet me kete ndryshim.

-Fjalen e merr z.Jonela Spaho (kryetare e grupit të këshilltarëve të djathtë) e cila thotë : Ju nuk i keni marre parasysh propozimet tonë. Eshte shkelur ligji per kuoten e Keshillit te Qarkut .Per kete arsyen si dhe per ato qe tha z.Thanas Kote lidhur me detajimin e projekteve ne jemi kunder miratimit te tij.

Diskutohet dhe debatohet nga keshilltaret (z.Beqiri,Kote,) dhe z.Peleshi rreth kesaj pike.

-Fjalen e merr z.Ilir Pendavinji kryetari i këshillit : Kush eshte dakort me kete material vetem me ndryshimin e pakesimit te grandit qe u tha nga z. Ekonomi.

Votimi 18 vota pro, 9 kunder, 0 abstenim.

Miratohet buxheti i Bashkise dhe i Institucioneve te Vartesise per vitin 2011 me ndryshimin (pakesimin) e grandit.

► Kalohet ne kerkesa e keshilltareve lidhur me miratimin e studimit urbanistik te qendres.

Fjalen e merr z.Agron Azisllari (këshilltar i djathë i P.D) i cili shprehet se ky eshte nje shqetesim i cdo qytetari te Korces. Kerkojme te miratohet sa me pare plani urbanistik i qendres se qytetit si dhe shprehim mendim kunder Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.238 date 23.03.201“PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË KORÇËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ.

Diskutohet nga keshilltaret (z.Kacani, z.Beqiri,z.Mero, z.Pendavinji, z.Themeli,z.Pandeli, znj.Nikaj,) dhe kryetari i bashkisë z.Peleshi rrëth kesaj pike. Mendohet te ngrihet nje grup pune per te pergaatitur materialin perkates për këtë çështje.

Diskutohet rrëth kerkeses se znj.Alma Iljazi per ndihme financiare, per karrocat me kafshe qe qarkullojne ne qytet etj.

Fjalën e merr z. Ilir Pendvinji Kryetari i Këshillit i cili e deklaron mbledhjen e myllur në orën 13.15.

Gjatë mbledhjes si dhe para dhe pas çdo votimi kishte pushime të shpeshta 5 minutëshe.

Nga zyra e transparencës Qytetare Korçë morrën pjesë personat e mëposhtëm :

Aleksandër Dino
Ridvan Meçollari
Lumturie Zerellari
Erget Cenoli
Pjerrin Simo
Engjellushe Kosturi

Mbledhja e grupit të nga ana e team-leaderit u caktua në orën 9.00 në ambientet e Bibliotekës ‘Thimi Mitko’ Korçë gjysëm ore përpëra orarit të caktuar për fillimin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë. Të gjithë anëtarët u paraqitën pa vonesa.

Gjatë takimit u ndanë detyrat në lidhje me vëzhgimin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë dhe maledhjen e informacionit të nevojshëm përpilimin e raportit.

Anëtarët e Zyrës së Transparencës Qytetare Korçë ishin të pranishëm gjatë gjithë zhvillimit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë.

Kryesisht ne nxjerjen e konkluzioneve përpilimin e raportit u përdorën shënimet e Pjerrinit dhe të Egertit si dhe informacioni i marrë nga sekretari i Këshillit të Bashkisë.

REFERENCA & INDEKSE

1. *Behet fjale konkretisht per nenet 33, 34 dhe 35 i ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.*
2. *E drejta kushtuese (neni 23) dhe ligjore (nenet 33-35 të ligjit 8652 'për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendre në Rep. e Shqipërisë", i ndryshuar).*
3. *Nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652, tëndryshuar, të cilat normojnë pothuajse plotësisht detyrimin për transparencë vendmarrese dhe pjesemarrje te publikut të nivel vendor. Monitorimi i implementimit të tyre nga Këshillit Bashkiak prodhon indikatorë objektivë për vlerësimin e transparencës në vendimarrjen lokale.*
4. *Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", është ndryshuar me ligj nr. 9208, dt. 18.03.2004*
5. *Neni 33, pika 4: "Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji."*
6. *PJESA E DYTË, kreu II I Kushtetutës*
7. *Eng: Proactive Disclosure.*
8. *Në rastin e Shqipërisë kjo është një e drejtë që garantohet nga Kushtetuta (neni 23) dhe nga ligji 8503 "Për të drejtën e Informimit mbi Dokumentata Zyrtare".*
9. *E drejta e pjesëmarrjes dhe informimit përfshihet në "TË DREJTAT DIIE LIRITË TIEMELORE TË NJERIUT", të garantuara nga Kushtetuta e Shqipërisë, konkretisht në nënin 23 të sa*
10. *Diskutimi me publikun është i detyrueshmë me ligj për rastet e vendimarrjes për Buxhetin, Paketën fiskale, tjetërsimin e pronave dhe në rastete miratimit të normave dhe standardeve përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë me ligj Këshillave (neni 35/1)*
11. *Garantimi i nje procesi te hapur vendimarrres dhe transparent me publikun nuk lihet ne vleresimin, diskrecioni apo ndergjegjen e te zgjedhurve lokalë, por është i rregulluar me ligj, kryesisht përmes neneve 33, 34 dhe 35.*
12. *neni 34 "Mbledhjet e hapura" dhe neni 35 "Seancat e këshillimeve me bashkësinë dhe e drejta e publikut për t'u informuar"*
13. *Medoda eshte pronesi intelektuale dhe eshte subjekt copyright. Perdorimi i saj aktivizohet përmes aplikimit me shkrim prane autorit te saj dhe vetem pasi ky aplikim te jete pranuar nga autor*
14. *Për ta arritur këtë klasifikim, hartuesit e këtij raporti janë referuar gjërisisht në botimin "E Drejta Administrative" – Botim IV i ripunuuar, nga Dr. Sokol Sadushi,*
15. *http://www.infocip.org/al/?page_id=269*
16. *Gjate vitit 2010, Keshilli Bashkiak Korçë ka marrë 134 vendime: Per me shume, kliko databazen e vendimeve te keshillit bashkiak Korce, vitit 2010: http://www.infocip.org/al/?page_id=434*
17. *Vetë ligji 8652, i ndryshuar, nuk saktëson se cfarë do të konsiderohet VKM me karakter normativ apo individual. Në përgjithësi edhe teoria e së drejtës administrative dhe jurisprudanca gjyqësore e kanë trajuar pak këtë dallim të rëndësishëm.*
18. *Shih modele të këtij raportimi në Aneksin Nr. 2*
19. *Kjo pikë e nemit 33 u ndryshua pas amnedimit të ligjit 8652 me ligjin 9208, dt. 18.03.2004 "Per disa shitesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8652, date 31.7.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"*
20. *Fjalia e dyti e paragrafit 6 nuk është objekt vlerësimi në kuadër të këtij moitorimi, paso ajo referon direkt një ligj tjeter, konkretisht ligjin 8503 "Për informimin mbi dokumentat zyrtare". Po ashiu, edhe Paragrafi 5 i nenit 33, nuk i është kushtuar hapësirë e posaçme në kuadër të kësaj pjese pasi në praktikë nuk janë ndeshur rrëthanat e parashikuar prej tij gjatë kohës së monitorimit të aktivitetit të Këshillit Bashkiak Korçë.*
21. *"E drejta Adminisitrative 2", Dr. Sokol Sadushi, Botim i katërt i ripunuuar, Shtëpia Botuese "Grand Prind", Tiranë, Shtator 2008.*
22. *Pikërisht për këtë qëllim, vendndoshja e kësaj Zyra ka qenë përvallë godinës së Bashkisë Korçë, për të lehtësuar sa më shumë të jetë e mundur monitorimin e stendës së bashkisë.*